

Udhëzues për menaxhimin e fondit grant

Përfshirë procedurat, termat e referencës, formularët e aplikimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre.

Shtator 2010

Pergatitur nga:

Blendi Bushati

Valbona Karakaçi

Aljon Koçkiçi

Asistuar nga:

Dieter Zürcher

Tabela e përmbajtjes

1. TË PËRGJITHSHME	1
2. STRUKTURAT E MENAXHIMIT TË GRANTIT.....	4
3. PËRZGJEDHJA.....	12
4. CIKLI I PROJEKTIT	15
5. BIBLIOGRAFIA.....	21
6. LISTA E SHTOJCAVE.....	22

Acronyms used:

dldp	Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
SCO-AI	Zyra e Bashkëpunimit Zviceran-Shqipëri

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Përshkrimi i dldp-së

Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (dldp) në Qarqet e Shkodrës dhe Lezhës është një program i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim e Zhvillim dhe i zbatuar nga INTERCOOPERATION, Fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Pas një faze të parë në vitet 2006-2009, të fokusuar në tetë Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV) në Qarkun e Shkodrës, dldp-ja filloi fazën e dytë të tij në mars 2010. Kjo fazë e dytë do të ketë një kohëzgjatje prej tre vitesh dhe projekti do të mbulojë 33 NJQV të Qarkut të Shkodrës dhe 21 të Qarkut të Lezhës. Qëllimi i dldp-së është: Kapacitetet e bashkive dhe komunave në Shkodër e Lezhë janë forcuar duke kontribuar në përmirësimin e zhvillimit rajonal në Veri të Shqipërisë dhe në reformën e decentralizimit në nivel kombëtar.

Një nga rezultatet e programit është: Bashkitë dhe Komunat në Qarqet e Shkodrës dhe të Lezhës kanë përmirësuar strukturat e tyre qeverisëse, kapacitetet dhe shërbimet e ofruara publike.

1.2 Përshkrimi i fondit grant

Dldp-ja, si pjesë e programit synon të ngrejë një skemë me fonde grant, nëpërmjet së cilës do të mbështesë NJQV-të partnere në përmirësime konkrete në shërbime publike dhe infrastrukturë, studime fizibiliteti, aktivitete informimi/komunikimi, përpunim studimesh dhe promovim të bashkëpunimit ndërkomunal.

Fondi grant duhet të shërbejë si një “fushë trajnimi e testimi” për NJQV-të në zonën e projektit për vendim-marrje transparente e me pjesëmarrje dhe menaxhim projektsh. Granti gjithashtu duhet tu mundësojë NJQV-ve të përfshira aksesin në fonde të tjera në nivel rajonal e kombëtar.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në skemën grant NJQV-të në dy Qarqet e projektit do të përfitojnë nga trajnimi, edhe individual për përgatitjen e projekteve me cilësi të lartë që do të rrisin efikasitetin e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Do të publikohen dy thirrje për aplikime (shtator 2010 dhe fundi i vitit 2011). Vendim-marrja për përzgjedhjen e projekteve për financim do të bëhet mbi baza konkurrimi, bazuar në ndikimet e pritshme, rëndësinë ndaj qëllimeve të programit dhe cilësinë e projekteve të propozuara.

Përzgjedhja do të bëhet në dy faza. Në fazën e parë NJQV-të do të përgatisin konceptet e projekteve; bazuar në vlerësimin e tyre do të përzgjidhen projektet më të mira. Në fazën e dytë NJQV-ve të kualifikuara do tu kërkohet të dorëzojnë projekt-propozimet e plota përfshirë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor (si projekti teknik, termat e referencës, planet e menaxhimit etj.) që të sigurohet gatishmëria e projekteve për financim.

Thirrjet për aplikim do të jenë të hapura për të gjithë NJQV-të e Qarqeve Shkodër dhe Lezhë. Gjatë fazës së aplikimit, NJQV-të do të përfitojnë trajnime në menaxhimin e ciklit të projektit dhe në shkrimin e projekt-propozimeve. NJQV-të, projektet e të cilave janë përzgjedhur për zbatim, do të jenë tërësisht përgjegjëse për zbatimin e tyre. Për menaxhimin financiar do të ndiqet skema e mbështetjes së pjesshme buxhetore. NJQV-të që do të përfitojnë nga fondi grant do të mbështeten më tej edhe me trajnime në fushën e prokurimit publik dhe të monitorimit e raportimit. Planifikohet që 12-15 njësi do të përfitojnë nga fondi grant për çdo raund aplikimesh.

1.3 Qëllimi i dokumentit

Qëllimi i këtij manuali është të shërbejë si udhëzues për shpërndarjen dhe menaxhimin e fondit grant të dldp për tu përdorur nga stafi i programit, bordi drejtues i këtij granti, vlerësuesit e jashtëm dhe NJQV-të e interesuara.

Ky manual përfshin:

- I. Përshkrimin e strukturave menaxhuese të grantit, raportet mes tyre.
- II. Përshkrimin e procedurave të përzgjedhjes dhe të zbatimit të projektit.
- III. Kriteret e alokimit të fondeve mes projekteve të ndryshëm.
- IV. Formularët e aplikimit për të dy fazat e aplikimit.

Ky udhëzues përshkruan procesin për raundin e parë të aplikimeve, bazuar në idenë që raundi i parë do të jetë pilot dhe përgjegjësia kryesore të vendim-marrjes e ka donatori, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Shqipëri (SCO-AL). Në raundin e dytë të aplikimeve, bordi drejtues i grantit, një trupë e përbërë nga të interesuarit kryesorë të programit, është parashikuar të ketë një rol më të madh në menaxhimin e procesit¹. Ndryshimet e mundshme në këtë manual për raundin e dytë duhet të reflektojnë mësimet e nxjerra nga raundi pilot.

1.4 Parimet e punës

- 1.4.1 **Paanshmëria.** Donatori SCO-AL, bordi drejtues i këtij granti dhe stafi i dldp nuk do të praktikojnë ndonjë formë diskriminimi apo trajtimi preferencial ndaj Njësive të Qeverisjes Vendore të Qarqeve Shkodër e Lezhë, kandidate të mundshëm për financim nga granti. Donatori, bordi drejtues, stafi i dldp dhe vlerësuesit e jashtëm do të aplikojnë kritere tërësisht transparente dhe të thjeshta, pjesë e këtij udhëzuesi, në procesin vendim-marrës për alokimin e fondeve.
- 1.4.2 **Transparenca.** Stafi i dldp-së dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore që do të zbatojnë projektet do të zbatojnë procedura të thjeshta, transparente e të kontrollueshme. Për sa të jetë e mundur, NJQV-të duhet të përfshijnë komunitetet vendore në të gjithë ciklin e projektit.
- 1.4.3 **Përfshirja e aspektit gjinor.** Projektet e propozuara duhet të konsiderojnë adresimin e pabarazive gjinore për aq sa të jetë e mundur. Cilësia e përfshirjes së aspekteve gjinore në projekte e propozuara do të jetë një kriter i rëndësishëm në vlerësimin e propozimeve.
- 1.4.4 **Kosto-efektshmëria.** Stafi i dldp-së dhe NJQV-të përfituese nga ky fond grant do të ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme për të siguruar maksimumin e përfitimeve brenda buxhetit të përcaktuar.
- 1.4.5 **Qëndrueshmëria.** NJQV-të përfituese nga projektet e financuara nga ky grant do të jenë përgjegjëse për funksionimin e mirëmbajtjen e projekteve pasi ato të jenë zbatuar. Ekzistenca e

¹Skema e menaxhimit të raundit të dytë të aplikimeve është parashtruar në letrën shoqëruese të këtij raporti nga konsulenti dhe skema e plotë është e përshkruar në draftin e parë të këtij raporti

një plani të qartë të qëndrueshmërisë për projektet e financuara do të jetë një pjesë e rëndësishme e kriterëve të vlerësimit për alokimin e fondeve. Projekt-propozimi, projekti teknik, zbatimi, funksionimi e mirëmbajtja duhet të jenë në përputhje me Ligjet Shqiptare për mjedisin. Atje ku është e mundur, do të merren të gjitha masat parandaluese apo zbutëse të ndikimeve të mundshme negative të projekteve në mjedis.

2. STRUKTURAT E MENAXHIMIT TË GRANTIT

2.1 Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran në Shqipëri (SCO-AL)

Përgjegjësitë e SCO-AL në raundin e parë të aplikimeve përfshijnë të mëposhtmet:

I. Aprovimi i procesit:

- Aprovimi i procesit të përgjithshëm, afateve kohore për shpërndarjen e grantit.
- Aprovimi i kriterëve për dy fazat e aplikimeve.
- Aprovimi i formularëve të aplikimit dhe dokumenteve të tjerë që u nevojiten NJQV-ve për të aplikuar në skemën e grantit.

II. Konfirmimi i vendimeve të ekspertizës teknike në dy fazat e aplikimit

- Konfirmimi i vendimeve të ekspertëve teknikë të Qarqeve në vlerësimin e parë të koncepteve të projekteve. Vendimi do të konsultohet në mbledhje me anëtarët e bordit drejtues.
- Aprovimi i kriterëve për kontraktimin e ekspertëve të jashtëm vlerësues për fazën e dytë të aplikimeve.
- Aprovimi i vlerësuesve të jashtëm të propozuar për tu kontraktuar nga stafi i dldp-së.
- Konfirmimi i vendimeve të ekspertëve të jashtëm në fazën e dytë të projekt propozimeve të plota. Vendimi do të konsultohet në mbledhje me anëtarët e bordit drejtues.

III. Rishikimi i udhëzuesit për raundin e dytë të aplikimit.

- Bazuar në komentet nga NJQV-të pjesëmarrëse, konsulentët e angazhuar nga programi dhe bordi drejtues, SCO-AL miraton ndryshimet për raundin e dytë të aplikimeve.

2.2 Bordi Drejtues

Bordi Drejtues i grantit do të jetë trupa kryesore e përbërë nga aktorët e rëndësishëm të programit që do të kenë një rol këshillues në këtë raund të parë pilot të programit.

2.2.1 Përbërja. Ky bord do të përbëhet nga shtatë persona përfaqësues politikë dhe në nivel teknik:

- Përfaqësuesi i Donatorit, Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran në Shqipëri.
- Kryetari i Qarkut Shkodër (mund ta delegojë tek Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Rajonal).
- Kryetari i Qarkut Lezhë (mund ta delegojë tek Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Rajonal).
- Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë (mund ta delegojë tek punonjës të tjerë të zyrës me përvojë të përshtatshme).
- Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë (mund ta delegojë tek punonjës të tjerë të zyrës me përvojë të përshtatshme).
- Përfaqësuesi i një donatori tjetër që punon në të njëjtën fushë².
- Përfaqësues nga shoqëria civile e qarqeve përfituese .

2.2.2 Përgjegjësitë e Bordit Drejtues përfshijnë:

² Në këtë raund mund të jetë përfaqësues nga programi i UNDP-së për Zhvillimin Rajonal për shkak edhe të harmonizimit të këtij granti me procedurat e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe ADA (Agjencia Austriake për Zhvillim) në raundin e dytë edhe për pritshmërinë e fillimit të zbatimit të projektit të përbashkët të Zhvillimit rajonal mes SDC dhe ADA në Qarqet përkatëse.

I. Këshillon donatorin për vendim-marrjen për përzgjedhjen e projekteve

- Jep komente për fazën e parë të përzgjedhjes së koncepteve të projekteve.
- Jep komente për fazën e dytë të përzgjedhjes përfundimtare të projekteve për tu financuar.

II. Miratim i raporteve të monitorimit dhe vlerësim i projektit të zbatuar më mirë:

- Miratim i raporteve përfundimtare të dërguara nga NJQV-të.
- Bazuar në këto raporte dhe të dhëna të tjera³ merr një vendim për projektin më të mirë dhe i jep mundësinë për një projekt tjetër NJQV-së me performancën më të mirë.

III. Rishikimi i udhëzuesit

- Bazuar në përvojën e raundit të parë i propozon donatorit rishikimin e udhëzimeve, procesit dhe përgjegjësive të aktorëve për raundin e dytë të grantit.

2.2.3 Funksionimi i Bordit Drejtues

Vendimet e bordit drejtues do të merren me konsensusin e të gjithë anëtarëve. Nëse nuk arrihet konsensusi mes të gjithë anëtarëve, shumica e thjeshtë e anëtarëve prezentë në mbledhje mjafton për të marrë vendimet.

Në fazën pilot, bordi drejtues do të kryesohet nga përfaqësuesi i donatorit SCO-AL.

Kryetari i bordit drejtues:

- Do të mbajë lidhje të ngushta me stafin e dldp për përgatitjen e materialeve për çdo mbledhje.
- Do të njoftojë datat e takimeve dhe axhendën për anëtarët e tjerë të bordit.
- Në koordinim me dldp-në do të përgatisë axhendën për çdo mbledhje.

Bordi Drejtues funksionon bazuar në disa rregulla të firmosura nga të gjithë anëtarët në mbledhjen e parë të tij.

³ Shih Shtojcën 5 për detajet e procesit të përzgjedhjes së projektit më të mirë.

2.3 Stafi i dldp-së

2.3.1 Marrëdhëniet me SCO-AL

- Përgatit udhëzuesit, kriteret, formularët e aplikimit dhe i dërgon tek donatori për miratim.
- Vepron si lehtësues i marrëdhënieve të donatorit me ekspertët e Qarkut në fazën e parë të aplikimit.
- Vepron si lehtësues i marrëdhënieve të donatorit me ekspertët e pavarur në fazën e dytë të aplikimit.

2.3.2 Marrëdhëniet me Bordin Drejtues

- Vepron si koordinator dhe lehtësues i Bordit Drejtues të grantit.
- Është përgjegjës për organizimin e takimeve të Bordit Drejtues
- Pjesëtarët e stafit të dldp-së marrin pjesë si vëzhgues pa të drejtë vote në të gjitha mbledhjet e bordit.
- Është përgjegjës për regjistrimin e diskutimeve në takime dhe mban arkivën e vendimeve të bordit drejtues.
- Përgatit të gjithë materialet e nevojshme për mbledhjet e Bordit Drejtues.

2.3.3 Përgjegjësitë në procesin e aplikimit

- Është përgjegjës për informimin e NJQV-ve aplikante të grantit nëpërmjet mbledhjeve të hapura në nivel Qarku.
- Pranon dhe regjistron të gjithë formularët e aplikimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, duke respektuar afatet e vendosura në të dy fazat e procesit.
- Është përgjegjës për trajnimin e Njësisve të Qeverisjes Vendore për përgatitjen e koncepteve të projekteve dhe projekt propozimeve të plota. Asiston NJQV-të e kualifikuara për në fazën e dytë në prokurim, monitorim dhe raportim.
- Përgjegjës për përgatitjen e Termave të referencës dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm
- Përgjegjës për informimin e NJQV-ve për rezultatet e aplikimit të tyre.⁴

⁴ Shih Shtojca1 “Letrat standarte të pranimit/refuzimit për të dy fazat”

- Përgjegjës për hartimin e planeve të investimit në të dy fazat, bazuar në miratimet e projekteve dhe buxhetin në dispozicion.

2.3.4 Përgjegjësitë në zbatim

- Përgjegjës për firmosjen e Marrëveshjes së Projektit me NJQV-të përfituese.
- Përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes financiare me NJQV-të.
- Përgjegjës për monitorimin e vazhdueshëm të performancës së projekteve dhe këshillimin e NJQV-ve për përmirësime kur të jetë e nevojshme.
- Përgjegjës për mbledhjen e informacioneve nëpërmjet raporteve narrative dhe financiare nga NJQV-të sipas kërkesave të marrëveshjes së projektit.
- Me qëllim sigurimin e produkteve dhe proceseve cilësore, në rastin e projekteve studimore, si studimet e fizibilitetit, projekte teknike, planet urbane, planet e menaxhimit të shërbimeve, zyrat me një ndalesë, projekteve në fushën e informimit dhe komunikimit, stafi i dldp-së do të sugjerojë kritere shtesë detyruese për t'u respektuar në procedurën e prokurimit dhe do të japë aprovimin e tij para fillimit të procesit të prokurimit. Brenda rregullave të prokurimit të Ligjit Shqiptar, duhet ti jepet përparësi cilësisë së ekspertëve të angazhuar
- Nëse do të gjykohet e arsyeshme, për këto lloj projektesh NJQV-të mund t'i delegojnë stafit të dldp-së zbatimin e projekteve/komponentëve të tillë.
- Stafi i dldp-së do të vendosë rast pas rasti nëse do ta pranojë këtë delegim bazuar në lidhjen e projektit me objektivat specifike të programit dhe ngarkesën në punë. Në çdo rast, detajet e marrëdhënieve mes NJQV-së, ekspertit dhe dldp-së përcaktohen në marrëveshjen e financimit.

2.3.5 Përgjegjësitë në shpërndarjen e përvojave më të mira

- Lehtëson procesin e përzgjedhjes së projektit më të mirë, duke dorëzuar raportet tek Bordi Drejtues.
- Shpërndan praktikatat më të mira

2.4 Njësitë e Qeverisjes Vendore

2.4.1 Përgjegjësitë në procesin e aplikimit

- Përgatit konceptin e projektit në përputhje me formularin e aplikimit⁵ shpërndarë nga stafi i dldp-së, duke respektuar afatet e aplikimit.
- Përgatit projekt propozimin e plotë në përputhje me formularin e aplikimit⁶ shpërndarë nga stafi i dldp-së, duke përfshirë angazhimin e buxhetit të mjaftueshëm për procesin e përgatitjes , nëse kjo është e nevojshme, duke respektuar afatet e aplikimit.
- Angazhimi i kontributit vendor financiar prej të paktën 20 % të shumës së projektit.
- Përgatitja e të gjitha lejeve, licencave të kërkuara nga Ligji Shqiptar përsa i përket përgatitjes së zbatimit të projektit.

2.4.2 Përgjegjësitë në zbatim

- Njësitë e Qeverisjes Vendore që do të përfitojnë financim të projekteve do të jenë institucioni direkt përgjegjës për zbatimin e projektit, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në marrëveshjen e projektit.
- NJQV-të do të jenë përgjegjëse për organizmin e procesit të prokurimit në përputhje me Ligjin Shqiptar.
- NJQV-të do të jenë përgjegjës për kontraktimin e supervisorëve të punimeve në rastin e kontratave të punimeve.

⁵ Shih Shtojca 2 “Formulari i Aplikimit për fazën e konceptit të projektit”

⁶ Shih Shtojca 3 “Formulari i aplikimit për fazën e projekt propozimit të plotë”

- NJQV-të do të jenë përgjegjëse për përgatitjen e projekt propozimeve të plota bazuar në projekte teknike/plane/studime fizibiliteti (veçanërisht në rastin e investimeve) si dhe të planifikojnë në buxhetin e tyre fonde për mirëmbajtjen të mjafta për të siguruar qëndrueshmërinë e investimit.
- Në rastin e projekteve studimore, në rast se vendoset që projekti të zbatohet nga stafi i dldp, NJQV-të do të jenë përgjegjëse për të bashkëpunuar në mënyrë të hapur e të plotë me stafin e dldp për të lehtësuar procesin e mbledhjes së informacionit organizmin e mbledhjeve publike, dhe marrjen e lejeve e miratimeve të nevojshme.

2.5 Ekspertët e Qarkut

Në fazën e parë të aplikimit, vlerësimi i koncepteve të projekteve do të bëhet nga ekspertë të dy qarqeve të përfshirë në program.

2.5.1 Përbërja e grupit të vlerëimit

Të dy Qarqet do të krijojnë një grup vlerësimi të përbërë nga tre ekspertë. Grupet do të drejtohen nga Drejtori i Departamentit të Zhvillimit të Qarkut dhe do të kenë nga dy anëtarë të tjerë në nivel specialisti. Përbërja e grupit të ekspertëve mund të miratohet nga donatori, SCO-AL.

2.5.2 Përgjegjësitë e Ekspertëve të Qarkut

- Lexim i kujdesshëm i të gjithë koncepteve të projekteve nga NJQV-të e Qarkut të tyre.
- Vlerësim i paanshëm i projekteve bazuar në kriteret e këtij udhëzuesi.
- Diskuton me ekspertët e konsulentëve të angazhuar nga projekti pikëzimin për të gjitha projektet.
- Përgatitja dhe dorëzimi tek stafi i dldp-së i raportit të vlerëimit.
- Reflektimi i komenteve dhe ndryshimeve kërkuar nga donatori.

2.6 Vlerësuesit e jashtëm

Në mënyrë që të arrihet shpërndarja e grantit bazuar në kritere teknike, stafi i dldp-së do të kontraktojë një grup ekspertësh të jashtëm për të bërë vlerësimin e projekt-propozimeve të plota. Një grup prej maksimumi tre ekspertësh do të punësohet nga stafi i dldp-së bazuar në termat e referencës⁷ të miratuar nga donatori. Ekspertët e jashtëm do t'i vlerësojnë projekt propozimet e plota bazuar në kriteret përkatëse, aneks i këtij manuali dhe në informacionin e dhëne nga NJQV-të në formularët e aplikimit.

2.6.1 Profili i vlerësuesve


Vlerësuesit duhet të kenë përvojë të konsiderueshme në bashkëpunim me NJQV-të, njohuri të sektorit të qeverisjes vendore në vend dhe njohurit të territorit të Qarqeve të programit. Përbërja e grupit të vlerësuesve do të jetë si më poshtë:

- Një inxhinier ndërtimi me përvojë në zbatimin/mbikqyrjen e projekteve të vogla të infrastrukturës në nivel komunal/bashkiak.
- Një ekspert i qeverisjes vendore/shërbimeve publike vendore
- Një ekspert i vlerësimit të ndikimit social-ekonomik

2.6.2 Përgjegjësitë e ekspertëve të jashtëm përfshijnë :

- Lexim i kujdesshëm i të gjithë koncepteve të projekteve nga NJQV-të e Qarkut të tyre.
- Vlerësim i paanshëm i projekteve bazuar në kriteret e këtij udhëzuesi.
- Përgatitja dhe dorëzimi tek donatori i raportit të vlerësimit.
- Reflektimi i komenteve dhe ndryshimeve kërkuar nga donatori.

Fig. 1 "Skema e vlerësimit të projektit"



⁷ Shih Shtojca 4 "Termat e referencës dhe kërkesat për vlerësuesit e pavarur"

3. PËRZGJEDHJA

3.1 Aplikantët e mundshëm

Aplikantë që mund të përfitojnë, janë të gjitha NJQV-të (bashki në zonat urbane e komuna në zonat rurale) në Qarqet Shkodër e Lezhë.

Projektet ndërkomunale janë të inkurajuara dhe do të përfitojnë nga një tavan më i lartë financimi për projekt në varësi të numrit të NJQV-ve që aplikojnë së bashku.

NJQV-të mund të aplikojnë në partneritet me shoqata lokale dhe/ose organizma të tjerë publikë me kusht që në fazat e aplikimit të ndahen mirë përgjegjësitë mes palëve. Në çdo rast, NJQV-ja duhet të jetë partneri kryesor, do të nënshkruajë marrëveshjen me dldp dhe do të jetë përgjegjësi i vetëm për zbatimin e projektit.

3.1.1 Kufizime për aplikant

Një NJQV mund të aplikojë vetëm për një projekt në një raund aplikimesh (pra, një NJQV aplikon vetëm për një projekt në vitin 2010 dhe një tjetër në vitin 2011).

Nëse NJQV-të aplikojnë me një propozim të përbashkët duhet të përcaktojnë qartë kush është aplikanti kryesor. Aplikanti kryesor do të jetë përgjegjës për zbatimin e projektit. Të gjitha NJQV-të në projektet e përbashkëta duhet të angazhohen për të kontribuar financiarisht në një raport të rënë dakord mes tyre paraprakisht.

3.2 Projekte që mund të financohen

Në parim granti mund të financojë të gjithë projektet që janë të lidhur drejtpërdrejt me funksionet e NJQV-ve, si përmirësimi i infrastrukturës, përmirësimi i shërbimeve publike, aktivitete të informimit e komunikimit, studime dhe plane, me kufizimet e mëposhtme:

- Ky grant nuk do të financojë rindërtimin e rrugëve
- Ky grant nuk do të financojë projekte të pjesshme. Projektet e financuar nga granti nuk duhet të varen nga financime të tjera.

Projektet e mundshëm për financim do të jenë si më poshtë:

I. Përmirësim i shërbimeve publike

- 1- Krijimi/rikonstruksioni i parqeve të vogla, lulishteve, këndeve të lojrave për fëmijë.
- 2- Riparimi i trotuareve, riparime të vogla urbane, sistemime sheshesh, ndriçim publik etj.
- 3- Përmirësim i shërbimit të pastrimit
- 4- Përmirësim i shërbimit të transportit publik, i sinjalistikës.
- 5- Kopshte, shtëpi për të moshuarit.
- 6- Qendra apo dhoma kulturore, komunitare.
- 7- Fusha sportive, përfshirë ambiente sportive të shkollave.
- 8- Përmirësime në rrjetin e ujësjellësit (p.sh vendosja e matësve)
- 9- Përmirësimi i tregjeve
- 10- Pasarela, rrugë biçikletash, shtigje turistike etj.
- 11- Plane urbanistike
- 12- Studime fizibiliteti
- 13- Përgatitje projektsh teknike

II. Informim dhe komunikim

- 1- **Infrastrukturë dhe pajisje**, të tilla si:

- Zyra me një ndalesë
- Qendra informimi publik
- Tabela informuese

- 2- **Përmirësimi i transparencës, komunikimit me qytetarët**, të tilla si :

- Ndërtim/përmirësim faqesh interneti
- Botim dhe shtypje buxhetesh lokalë

- Fushata mediatike për përmirësimin e transparencës në vendim-marrjen lokale.
- Projekte për përmirësimin e pjesëmarrjes së grupeve vulnerabël
- Dixhitalizim i të dhënave, taksave, aseteve.
- Studime rreth perceptimit të qytetarëve për çështjet lokale etj.

Nëse projekti nuk është në listën e mësipërme, aplikanti duhet ta diskutojë idenë me stafin e dldp-së dhe organizatën e ngarkuar për fazën e informimit/trajnitimit për të marrë një miratim paraprak për të vazhduar me aplikimin.

Një kombinim i projekteve studimore (plane, studime) me investimet është i mundur nëse janë komplementare me njëra-tjetrën (p.sh një plan për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe zbatimimi i këtij plani)

Projekte ndërkomunale janë të mundshme për të dyja kategoritë.

3.3 Kostoja e projektit dhe kontributi lokal

Kostoja e mbuluar nga dldp-ja duhet të jetë nga 10,000 deri në 40,000 Euro.

Në rastin e projekteve ndërkomunale, limiti i buxhetit rritet proporcionalisht me numrin e NJQV-ve që aplikojnë. Tavani i financimit do të jetë tavani për një NJQV shumëzuar me numrin e NJQV-ve përfituese (pra, 80,000 Euro nëse dy NJQV aplikojnë bashkë e kështu me radhë). Në çdo rast, buxheti i akorduar për projekte ndërkomunale nuk duhet të kalojë 50 % të buxhetit total në çdo raund.

Kontributi lokal duhet të jetë të paktën 20 % i kostos totale të projektit. NJQV-ve që do të kenë një kontribut më të madh do tu jepet një pikëzim më i lartë në mekanizmin e vlerësimit.

Kostot e financueshme janë kontrata punimesh dhe kontrata shërbimesh. Kostot e projektit nuk do të mbulojnë pagat për personelin e Njësitë të Qeverisjes Vendore. Aktivitetet e projektit në çdo rast, studime, fushata informimi apo punime civile duhet të kryhen nga kontraktorë apo ofrues shërbimesh të specializuar në fushat përkatëse.

Blerja e tokave apo ndërtesave qoftë edhe për qëllimet e projektit nuk është e lejuar.

Kostoja e projektit duhet të mbulojë edhe taksat. TVSH-ja do të mbulohet nga kontributi i NJQV-së.

Kostot e supervizionit dhe kolaudimit do të mbulohen nga NJQV-ja jashtë kostos së projektit.

4. CIKLI I PROJEKTIT

4.1 Informimi

Stafi i dldp-së, nëpërmjet një organizate të specializuar do të informojë të gjithë aplikantët që mund të përfitojnë, për rregullat dhe mundësinë e përftimit nga fondi grant. Informacioni do të jepet nëpërmjet mbledhjeve publike në nivel Qarku me përfaqësuesit e NJQV-ve që mund të përfitojnë nga financimi.

4.2 Identifikimi i projekteve

Identifikimi i projekteve është përgjegjësi e NJQV-ve. NJQV-të duhet të sigurohen të zgjedhin për aplikim projekte që përmbushin kriteret e detyrueshme të bëra publike gjatë sesioneve të informimit.

4.3 Përgatitja e koncepteve të projekteve

NJQV-të përfituese do të jenë përgjegjëse për përgatitjen e koncepteve të projekteve në përputhje me formatin e aplikimit shpërndarë nga dldp-ja. Gjatë sesioneve të informimit/trajnitimit, stafi i dldp-së/organizata e kontraktuar për këtë qëllim do të prezantojë objektivat dhe rregullat e grantit dhe do të trajnojë aplikantët e mundshëm në përgatitjen e koncept-projekteve dhe në menaxhimin e ciklit të projektit.

4.4 Faza e parë: Vlerësimi dhe filtrimi i koncepteve të projekt propozimeve

Projektet do të vlerësohen nga një grup ekspertësh i Qarqeve Shkodër dhe Lezhë si dhe nga konsulentët e angazhuar nga projekti sipas ekspertizës së tyre në fushat përkatëse.

Vlerësimi do të bëhet bazuar në informacionin e ofruar nga NJQV-ja aplikante në formularin e aplikimit dhe në dokumente të tjera nëse i janë bashkangjitur aplikimit.

Vlerësimi do të bëhet bazuar në kritere të detyrueshme dhe vlerësuese.

Në fazën e parë të vlerësimit do të kontrollohen kriteret e detyrueshme dhe aplikimet që nuk përmbushin kriteret e detyrueshme do të skualifikohen. Staf i dldp-së do të verifikojë nëse aplikimet i përmbushin kriteret e detyrueshme.

Kriteret e detyrueshme në këtë fazë janë si më poshtë:

- A) Koncept-projekti i propozuar është një funksion i drejtpërdrejtë i Njesisë së Qeverisjes Vendore.
- B) Koncept-projekti është dorëzuar në kohë
- C) Projekti i propozuar nuk është një investim i pjesshëm
- D) Konfirmimi i NJQV-së për të bashkëfinancuar të paktën 20 % të shumës së projektit.
- E) Vendim i Këshillit të NJQV-së për mbështetjen e projektit.
- F) Koncept-projekti është pjesë e Dokumentit Strategjik (Plan Zhvillimi Strategjik, Plan Zhvillimi Ekonomik etj.)
- G) Projekt-propozimi ka marrë parasysh aspektet gjinore
- H) Konfirmimi për çështje pronësie

Aplikimeve që kualifikohen do tu vendoset një pikëzim bazuar në kriteret e vlerësimit⁸ që përfshijnë vlerësimin e ndikimit të pritshëm social-ekonomik në jetën e komuniteteve përfituese dhe kriteret institucionale që vlerësojnë cilësinë e propozimit të dorëzuar.

Koncept-projektet do të renditen bazuar në pikët e marra dhe stafi i dldp-së bazuar në ndarjen e buxhetit për lloj projektësh do t'i propozojë donatorit për numrin e projekteve për tu kualifikuar për në fazën tjetër.

⁸ Shih bashkangjitur shtojcën 5 “Kriteret dhe procesi i vlerësimit për të dy fazat e konkurrimit dhe përzgjedhjen e projektit më të mirë”.

Në mënyrë që të arrihet një pjesëmarrje e drejtë në konkurrim nga të dy Qarqet, projektet e kualifikuara në këtë fazë do të jenë 60 % nga Qarku i Shkodrës dhe 40 % nga Qarku i Lezhës⁹.

Stafi i dldp-së do të njoftojë zyrtarisht aplikantët si në rastin e moskualifikimit të propozimit të tyre ashtu edhe në rastin e ftesës për përgatitjen e projekt propozimit të plotë.

4.5 Përgatitja e projekt propozimeve të plota

Stafi i dldp-së do t'i kërkojë NJQV-ve të kualifikuara të përgatitin një projekt propozim të plotë.

Projekt propozimi i plotë duhet të përgatitet nga NJQV-ja në përputhje me formatin e aplikimit shpërndarë nga dldp-ja duke respektuar afatet e dorëzimit.

NJQV-ve që u është kërkuar të përgatisin projekte propozimin e plotë do të trajnohen edhe individualisht nga një konsulent i specializuar në shkrim projektesh dhe menaxhim të ciklit të projektit.

4.6 Vlerësimi i projekt propozimeve të plota

Projektet do të vlerësohen nga një grup ekspertësh të jashtëm të pavarur që do të kontraktohen nga dldp-ja me aprovimin e donatorit.

Vlerësimi do të bëhet bazuar në informacionin e ofruar nga NJQV-ja aplikante në formularin e aplikimit dhe në dokumente të tjera nëse i janë bashkangjitur aplikimit.

Vlerësimi do të bëhet bazuar në kriteret vlerësuese meqenëse projektet e kualifikuara i kanë përmbushur kriteret e detyrueshme që në fazën e parë të vlerësimit.

Aplikimi, përveç projekt propozimit të plotë, do të përmbajë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të qenë gati për zbatim (dokumente të tillë si projekte teknike në rast investimesh, terma të referencës në raste studimesh, planesh urbanistike; lejet e nevojshme lëshuar nga autoritetet përkatëse etj.)

⁹ (P.sh nëse numri total i projekteve të kualifikuara në këtë fazë do të jetë 20, 12 do të jenë nga Qarku Shkodër dhe 8 nga Qarku Lezhë). Kjo shpërndarje reflekton raportin e numrit të NJQV-ve mes dy Qarqeve.

Qëndrueshmëria e projektit do të jetë një nga kriteret kryesore të vlerësimit. Në varësi të tipit të projektit, plani i funksionimit/mirëmbajtjes së investimit, një plan për hapat e mëtejshëm që komuna/bashkia do të ndërmarrë pas përfundimit të projektit në rastin e studimeve apo fushatave informative do t'i bashkëngjitet formularit të aplikimit. Në të njëjtën kohë, si pjesë e aplikimit, NJQV-ja duhet të tregojë se aspektet gjinore janë marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së projekt propozimit. Gjithashtu NJQV-ja duhet të bëjë të demonstrojë se projekti mund të realizohet brenda një periudhe gjashtë mujore.

Aplikimet që kualifikohen do të marrin një pikëzim bazuar në kriteret e vlerësimit¹⁰ që do të jenë më tepër të përqendruara në analizën e detajuar të cilësisë së projekt propozimit dhe dokumentacionit shoqërues. Projekt propozimet do të renditen në bazë të pikëve që do marrin.

4.7 Vendim-marrja dhe përgatitja e planit të punës

Donatori, SCO-AL, në konsultë me Bordin Drejtues, bazuar në buxhetin në dispozicion dhe buxhetin e kërkuar nga çdo projekt do të vendosin për numrin e projekteve për tu financuar.

Donatori do të miratojë listën përfundimtare të projekteve për financim bazuar në raportet e vlerësuesve të jashtëm.

Stafi i dldp-së do të njoftojë zyrtarisht aplikantët si në rastin e moskualifikimit të propozimit të tyre ashtu edhe në rastin e ftesës për firmosjen e marrëveshjes së financimit. .

4.8 Marrëveshja mes dldp-së dhe NJQV-ve

Pas miratimit, dldp-ja do të firmosë një marrëveshje me secilën nga NJQV-të, të cilave iu është miratuar projekti, duke detajuar të gjitha procedurat e zbatimit të projektit, ku rolet e përgjegjësitë e të dy palëve janë të përcaktuara qartë¹¹.

¹⁰ Shih bashkangjitur shtojcën 5 “Kriteret dhe procesi i vlerësimit për të dy fazat e konkurrimit dhe përzgjedhjen e projektit më të mirë”

¹¹ Shih bashkangjitur Shtojcën 6 “Marrëveshja e Zbatimit të projektit”

Projekt propozimi dhe dokumentacioni i përgatitur do t'i bashkëngjiten marrëveshjes. Sidoqoftë, bazuar në gjykimin më të mirë nga stafi i dldp-së apo në ekspertizën e vlerësuesve, në kohën mes miratimit të projektit dhe nënshkrimit të marrëveshjes së zbatimit të projektit, stafi i dldp-së mund t'i kërkojë NJQV-së të reflektojë ndryshimet e përshtatshme. Në këtë rast mbizotëron marrëveshja e zbatimit të projektit.

4.9 Zbatimi i projekteve

Zbatimi i projekteve është përgjegjësi e Njësive të Qeverisjes Vendore; përveç rasteve kur cilësohet ndryshe në marrëveshje. Në këto raste, detajet e marrëdhënies trepalëshe mes NJQV-së, konsulentit dhe stafit të dldp-së përcaktohen në marrëveshje.

4.9.1 Prokurimi

Të gjitha aktivitetet do të zbatohen nëpërmjet kontraktimit të kontraktorëve privatë/ofruesve të shërbimeve të konsulencës që do të për zgjidhen nëpërmjet një procesi tenderimi të hapur dhe transparent.

Prokurimi do të ndjekë Ligjin Shqiptar të Prokurimit. Nëpërmjet programit do të ofrohet një trajnim nga Agjensia e Prokurimit Publik (APP)

Organizimi i procesit të prokurimit është përgjegjësi e plotë e NJQV-së. Stafi i dldp-së mund të marrë pjesë si vëzhgues në procesin e tenderimit.

Me qëllim sigurimin e produkteve dhe proceseve cilësore, në rastin e projekteve studimore, si studimet e fizibilitetit, projekte teknike, planet urbane, planet e menaxhimit të shërbimeve, zyrat me një ndalesë, projekteve në fushën e informimit dhe komunikimit, stafi i dldp do të sugjerojë kritere shtesë detyruese për t'u respektuar në procedurën e prokurimit dhe do të japë aprovimin e tij para fillimit të procesit të prokurimit. Brenda rregullave të prokurimit të Ligjit Shqiptar, duhet t'i jepet përparësi cilësisë së ekspertëve të angazhuar.

Nëse do të gjykohet e arsyeshme, për këto lloj projektesh NJQV-të mund t'i delegojnë stafit të dldp-së zbatimin e projekteve/komponentëve të tillë Stafi i dldp-së do të vendosë rast pas rasti nëse do ta pranojë këtë delegim bazuar në lidhjen e projektit me objektivat specifike të programit dhe ngarkesën në punë.

Në çdo rast, detajet e marrëdhënieve mes NJQV-së, ekspertit dhe dldp-së përcaktohen në marrëveshjen e financimit

4.9.2 Monitorimi i ecurisë

Sapo kontrata të jenë nënshkruar me sipërmarrësit për zbatimin e projekteve, NJQV-të do të raportojnë në mënyrë periodike tek stafi i dldp-së nëpërmjet formateve të raportimit që do të shpërndahen¹².

Kur ta gjykojë të arsyeshme, stafi i dldp-së dhe ekspertët teknikë të kontraktuar prej tyre mund të organizojnë vizita në vendndodhjen e projekteve në prezencë të përfaqësuesve të NJQV-së.

Stafi i dldp-së ka të drejtën të bëjë komente me shkrim për zbatimin e projekteve dhe mund të këshillojë NJQV-të për përmirësimin e cilësisë së zbatimit të projektit. Në rast se NJQV-ja nuk zbaton kërkesat për përmirësimin e cilësisë, dldp-ja rezervon të drejtën për tërheqjen e financimit. Detajet e kësaj marrëdhënie janë në marrëveshjen e zbatimit.

Siç është rënë dakord në marrëveshjen e projektit, në rastin e projekteve studimore, stafi i dldp-së mund të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për të ndjekur ecurinë e kontratës në bashkëpunim të ngushtë me NJQV-në përfituese.

4.9.3 Kriteret dhe procesi i përzgjedhjes për projektin më të mirë¹³

Pas zbatimit të projekteve gjatë raundit të parë të zbatimit të fondit grant do të përzgjidhet projekti më i mirë. NJQV-ja që ka zbatuar projektin më të mirë do të ketë mundësinë e financimit të një projekti tjetër që përputhet me kriteret e financimit të udhëzuesit. Projekti më i mirë do të përzgjidhet nga bordi drejtues i projektit bazuar në disa kriteret që do të vlerësojnë performancën e të gjithë projekteve të zbatuara.

Kriteret vlerësuese për projektin më të mirë do të përfshijnë:

¹² Shih shtojcën 8 “Formati i raportimit”

¹³ Kriteret dhe procesi për përzgjedhjen e projektit më të mirë janë përshkruar më në detaje në Shtojcën 5: “Kriteret dhe procesi i vlerësimit për të dy fazat e konkurrimit dhe përzgjedhjen e projektit më të mirë”.

- Cilësia dhe afatet e zbatimit të projektit.
- Cilësia e raportimit.
- Cilësia e pjesëmarrjes së komuniteteve përfituese gjatë projektit.
- Vizibiliteti i projektit në median lokale e qendrore.

5. BIBLIOGRAFIA

- European Commission, Directorate General for Humanitarian Aid -ECHO, “Manual Project Cycle Management”, 2005.
- Fondi Shqiptar I Zhvillimit, përgatitur në kuadër të dldp “Raport rreth kriterëve të përdorura nga donatorë të ndryshëm në Shqipëri”, 2008.
- BDPA, EU-funded project “Cross Border Institutional Building, Project Preparation Manual”, 2007.
- The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe “Project Proposal Writing”, 2002.
- World Bank, Project Appraisal Document Moldova Social Investment Fund; Report No.18401-MD “Appraisal Criteria for Microprojects”, 2005.
- Udhëzim për procesin e kriteret e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, 2010.

Dhënë nga dldp si pjesë e termave të referencës :

- Kriteret dhe formularët e aplikimit, LOGOS Investment Fund, Kosovo.
- Kriteret dhe formularët e aplikimit përdorur nga programi i GTZ dhe Këshilli I Qarkut Shkodër.

Burime të tjera:

- Faqja e internetit e Fondit Shqiptar të Zhvillimit: <http://www.albaniandf.org/>
- Faqja e internetit e Komisionit European http://ec.europa.eu/index_en.htm

6. LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1	Letër standarde pranimi/refuzimi për të dy fazat
Shtojca 2	Formulari i aplikimit për fazën e konceptit të projektit.
<i>Shtojca 2_1</i>	<i>Udhëzime për përgatitjen e formularit të aplikimit për fazën e konceptit të projektit.</i>
Shtojca 3	Formulari i aplikimit për fazën e projekt propozimit të plotë
<i>Shtojca 3_1</i>	<i>Udhëzime për plotësimin e formularit të aplikimit për fazën e projekt propozimit të plotë</i>
Shtojca_4	Termet e referencës dhe kërkesat për vlerësuesit e pavarur
Shtojca 5	Procesi i vlerësimit dhe kriteret që do të përdoren në dy fazat e aplikimit dhe për përzgjedhjen e projektit më të mirë:
<i>Shtojca 5_1</i>	<i>Udhëzim për përdorimin e kriterëve për vlerësuesit në fazën e koncepteve të projekteve:</i>
<i>Shtojca 5_2</i>	<i>Shpjegimi i kriterëve për vlerësuesit për fazën e projekt propozimeve të plota :</i>
<i>Shtojca 5_3</i>	<i>Formati i raportimit për vlerësuesit për fazën e projekt-koncepteve</i>
<i>Shtojca 5_4</i>	<i>Formati i raportimit për vlerësuesit për fazën e projekt-propozimeve të plota</i>
Shtojca 6	Marrëveshja e bashkëfinancimit me bashkinë/komunën
Shtojca 7	Letër standarde e konfirmimit të pronësisë
Shtojca 8	Formulari i raportit përfundimtar
<i>Shtojca 8_1</i>	<i>Udhëzime për përgatitjen e formularit të raportit përfundimtar</i>
Shtojca 9	Rregullorja e Funkcionimit të Bordit Drejtues të fondit grant të dldp

Shtojca 1: Letër standarde pranimi

_____, datë / /201

Drejtuar: Z./Znj. _____, Kryetar i Komunës/Bashkisë _____

Lënda: Rreth rezultateve të aplikimit tuaj për fazën e parë të fondit grant të dldp

I/E nderuar Z./Znj. _____

Sic jeni informuar nga sesionet e informimit organizuar për këtë qëllim, për vlerësimin e koncepteve të projekteve dorëzuar nga NJQV-të e Qarqeve Shkodër e Lezhë, u ngrit një grup ekspertësh me përfaqësues nga stafi i Qarkut, ku NJQV-ja juaj bën pjesë.

Pas vlerësimit të koncept-projektit tuaj, ju informojmë se projekti mori xx nga 100 pikë të mundshme në vlerësim. Me kënaqësi, ju njoftojmë se ky pikëzim ju lejon të kualifikoheni për në fazën e dytë ku do t'ju kërkohet të sillni një projekt propozim të plotë.

Do t'ju vëmë në dijeni për datën dhe orën e sesionit të informimit për përgatitjen e projekt propozimit të plotë.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj në këtë proces,

Në emër të DLDP-së,

Emri, Mbiemri, Vula

Letër standarde refuzimi

_____, datë / /201

Drejtuar: Z./ZJ. _____, Kryetar i Komunës/Bashkisë _____

Lënda: Rreth rezultateve të aplikimit tuaj për fazën e parë të fondit grant të dldp-së

I/E nderuar Z./Znj. _____

Siç jeni informuar nga sesionet e informimit organizuar për këtë qëllim, për vlerësimin e koncepteve të projekteve dorëzuar nga NJQV-të e Qarqeve Shkodër e Lezhë, u ngrit një grup ekspertësh me përfaqësues nga stafi i Qarkut ku NJQV-ja juaj bën pjesë.

Pas vlerësimit të koncept-projektit tuaj, ju informojmë se projekti mori xx nga 100 pikë të mundshme në vlerësim. Me keqardhje ju njoftojmë se ky pikëzim nuk ju lejon të kualifikoheni për në fazën e dytë të vlerësimit. Projekti i fundit që u kualifikua për në fazën e dytë mori xx nga 100 pikë të mundshme.

Ndër arsyt kryesore që projekt-koncepti juaj nuk arriti të fitonte ishin (cito nga vlerësimet e ekspertëve tek kriteret me rezultatin më të ulët)

-P.sh Mungesa e një koncepti të qartë të projektit etj.

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në aplikim dhe ju inkurajojmë që të merrni pjesë në raundin tjetër të aplikimeve vitin e ardhshëm.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj në këtë proces,

Në emër të DLDP-së

Emri, Mbiemri, Vula

Letër standarde pranimi

_____, datë / /201

Drejtuar: Z./Znj. _____, Kryetar i Komunës/Bashkisë _____

Lënda: Rreth rezultateve të aplikimit tuaj për fazën e dytë të fondit grant të dldp-së

I/E nderuar Z./Znj. _____

Siç jeni informuar nga sesionet e informimit organizuar për këtë qëllim, për të vlerësuar projekt-propozimet e plota dorëzuar nga NJQV-të e Qarqeve Shkodër e Lezhë, programi ynë kontraktoi një grup ekspertësh të pavarur për kryerjen e vlerësimit.

Pas vlerësimit të koncept-projektit tuaj, ju informojmë se projekti mori xx nga 100 pikë të mundshme në vlerësim. Me kënaqësi ju njoftojmë se ky pikëzim bën që projekti juaj të mbështetet me financim nga ky grant.

Stafi ynë do t'ju kontaktojë për hapat e mëtejshëm për përfundimin e marrëveshjes së financimit dhe vazhdimin me zbatimin e projektit.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj në këtë proces,

Në emër të DLDP-së,

Emri, Mbiemri, Vula

Letër standarde refuzimi

_____, datë / /201

Drejtuar: Z./Znj. _____, Kryetar i Komunës/Bashkisë _____

Lënda: Rreth rezultateve të aplikimit tuaj për fazën e dytë të fondit grant të dldp-së

I/E nderuar Z./Znj. _____

Siç jeni informuar nga sesionet e informimit organizuar për këtë qëllim, për të vlerësuar projekt-propozimet e plota dorëzuar nga NJQV-të e Qarqeve Shkodër e Lezhë, programi ynë kontraktoi një grup ekspertësh të pavarur për kryerjen e vlerësimit.

Pas vlerësimit të koncept-projektit tuaj, ju informojmë se projekti mori xx nga 100 pikë të mundshme në vlerësim. Për shkak të buxhetit të kufizuar në dispozicion, me keqardhje ju njoftojmë se ky vlerësim e bën të pamundur financimin e projektit tuaj. Projekti i fundit që do të përfitojë nga financimi mori xx nga 100 pikë të mundshme.

Ndër arsyt kryesore që projekt-koncepti juaj nuk arriti të fitonte ishin **(cito nga vlerësimet e ekspertëve tek kriteret me rezultatin më të ulët)**

-P.sh Mungesa e një koncepti të qartë të projektit etj.

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në aplikim dhe vlerësojmë shumë punën e bërë nga ju dhe stafi juaj në të dy hapat e këtij procesi. Ju inkurajojmë që të merrni pjesë në raundin tjetër të aplikimeve vitin e ardhshëm.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj në këtë proces,

Në emër të DLDP-së,

Emri, Mbiemri, Vula

Shtojca 2: Formulari i aplikimit për fazën e konceptit të projektit

1. Të dhëna të përgjithshme

Aplikanti/ët:	
Personi/at e kontaktit:	
Titulli i projektit	
Vendndodhja	
Buxheti i kërkuar nga dldp-ja	
<i>Data e dorëzimit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-së)</i>	
<i>Numri i projektit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-së)</i>	

2. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për këtë projekt; a është projekti i harmonizuar me dokumentet strategjike të NJQV-së suaj? (jo më tepër se 1 fq.)

--

3. Përshkrimi i projektit (jo më tepër se 1 fq.)

3.1 Titulli i projektit	
3.2 Qëllimi i projektit	
3.3 Objektivi/at specifikë të projektit	
3.4 Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit	
3.5 Aktivitetet e projektit. Listoni aktivitetet kryesore dhe kohëzgjatjen e tyre.	
3.6 Kostoja e projektit (në Euro)	
<i>Vlera totale e projektit</i>	
<i>Buxheti i kërkuar nga dldp</i>	
<i>Buxheti i kontribuar nga NJQV-ja</i>	

Ju lutem përshkruani si e keni llogaritur koston e projektit.

4. Grupet e synuar dhe përfituesit (jo më tepër se 0.5 fq.)

5. Informacion tjetër (jo më tepër se 0,5 fq.)

Bashkangjitur këtij dokumenti do të gjeni:

1. Vendimin e Këshillit të NJQV-së që pohon se projekti është prioritet dhe mbështetet nga Këshilli.
2. Konfirmimin që NJQV-ja do të bashkëfinancojë projektin me të paktën 20 % të shumës totale të projektit.
3. Konfirmim që projekti i propozuar është një pronë publike. (kjo nuk është e nevojshme në rastin e projekteve “studimore”)
4. Konfirmim që NJQV-të pjesëmarrëse në projekt njohin rolin kryesor të NJQV-së kryesore në aplikim (vetëm në rastin e projekteve ndërkomunale)
5. ¹ _____
6. _____

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-së

¹ Për tu plotësuar në rast se i keni bashkangjitur shtojca të tjera aplikimit.

Shtojca 2 1: Udhëzime për përgatitjen e formularit të aplikimit për fazën e konceptit të projektit

1. Të dhëna të përgjithshme

Aplikanti/ët:	<i>Emri i NJQV-së, Qarku. Në rast të bashkëpunimit ndërkomunal, listojini të gjitha NJQV-të, duke cilësuar aplikantin kryesor.</i>
Personi/at e kontaktit:	<i>Emri, adresa, numri i telefonit i personit përgjegjës për mbajtjen e kontakteve në lidhje me projektin.</i>
Titulli i projektit	<i>Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konciz dhe tu referohet objektivave apo aktiviteteve kyçe të projektit.</i>
Vendndodhja	<i>Fshati, lagja, vendndodhja e saktë ku do të zbatohet projekti.</i>
Buxheti i kërkuar nga dldp-ja	<i>Vendosni shumën në Euro ¹</i>
<i>Data e dorëzimit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-së)</i>	<i>Ju lutem lini kutinë bosh</i>
<i>Numri i projektit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-së)</i>	<i>Ju lutem lini kutinë bosh</i>

2. **Sfondi dhe analiza e problemit.** Një analizë e shkurtër e situatës që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për këtë projekt; a është projekti i harmonizuar me dokumentet strategjike të NJQV-së suaj? (jo më tepër se 1 fq.)

Paragrafi i parë jep të dhëna të përgjithshme për Njësinë e Qeverisjes Vendore, të dhëna të vendndodhjes gjeografike, karakteristikat bazë demografike, ekonomike etj.

Paragrafi i dytë përmban përshkrim të sektorit/nësektorit në territorin e NJQV-së tuaj, në të cilin do të kontribuojë projekti dhe gjendjen ekzistuese të shërbimit që ju po synoni të ndryshoni me anë të projektit.

Shpjegoni qartë problemin që është në qendër të projektit tuaj. Seksioni i shtjellimit të problemit jep një përshkrim të problemit (-eve) specifike që projekti përpiqet t'i zgjidhë, në mënyrë që të justifikohet nevoja për këtë projekt.

Gjithashtu, përgjigjuni çështjeve të mëposhtme:

1.1 A është projekti pjesë e prioriteteve afat-shkurtra të planit të Zhvillimi Lokal apo Rajonal, i planit të përdorimit të tokës, planit urbanistik apo ndonjë dokumenti tjetër strategjik në nivel lokal? (ju lutem citoni dhe bashkëngjitni një kopje të dokumentit)

1.2 A është projekti pjesë e buxhetit afat-mesëm aprovuar nga NJQV-ja juaj? (ju lutem citoni dhe bashkëngjitni një kopje të dokumentit)

¹ Nëse buxheti është në Lekë Shqiptare, përdorni kursin ditor zyrtar të këmbimit nga Banka e Shqipërisë

3. Përshkrimi i projektit (jo më tepër se 1 fq.)

<p>3.1 Titulli i projektit <i>Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konciz dhe t'i referohet objektivave apo aktiviteteve kyçe të projektit.</i></p>	
<p>3.2 Qëllimi i projektit <i>Kur të formuloni qëllimin e projektit, ju lutem mbani parasysh se realizmi i projektit tuaj kontribuon në arritjen e qëllimit por nuk e arrin drejtpërdrejt atë. Një projekt duhet të ketë vetëm një qëllim.</i></p>	
<p>3.3 Objektivi/at specifike të projektit <i>Objektiv/at specifike të projektit duhet tu referohen problemit kryesor të identifikuar dhe duhen shprehur si përfitime nga përfituesit e projektit apo grupi i synuar si një rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes së projektit.</i></p>	
<p>3.4 Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit <i>Rezultatet përshkruajnë shërbimet apo produktet që u dorëzohen përfituesve të synuar të projektit. Kjo është ajo çka projekti premtan të dorëzojë. Rezultatet janë më të detajuara se objektivat dhe qëllimi i projektit; ata duhet të jenë të mundshme për tu matur përmes përdorimit të treguesve objektivë.</i></p>	
<p>3.5 Aktivitetet e projektit. Listoni aktivitetet kryesore dhe kohëzgjatjen e tyre. <i>Plani i aktiviteteve duhet të përmbajë informacion dhe shpjegime specifike për secilin nga aktivitetet kryesore të planifikuara. Kohëzgjatja e planifikuar e projektit dhe e aktiviteteve kryesore duhet të sqarohen mirë.</i></p>	
<p>3.6 Kostoja e projektit (në Euro) <i>Jepni një paravlerësim të buxhetit duke treguar bazën mbi të cilën janë kryer llogaritjet (p.sh bazuar në aktivitete të mëparshme të kryera nga NJQV-ja juaj, projekte të ngjashme kryer nga organizata të tjera, manual çmimesh, nëse ka të tillë etj.) Nëse ju tashmë e keni të përgatitur një analizë të detajuar të koston, projekt e preventiv apo plan, ju lutem referohuni atij dokumenti. Tregoni buxhetin që nevojitet nga donatori dhe buxhetin që do të kontribuohet nga NJQV-ja. (Mbani parasysh limitet e buxhetit që mund të kontribuohet nga donatori) .</i></p>	
<i>Vlera totale e projektit</i>	<i>1=2+3</i>
<i>Buxheti i kërkuar nga dldp-ja</i>	<i>2</i>
<i>Buxheti i kontribuar nga NJQV-ja</i>	<i>3</i>
<p><i>Ju lutem përshkruani si e keni llogaritur koston e projektit.</i></p>	

4. Grupet e synuar dhe përfituesit (jo më tepër se 0.5 fq.)

Përcaktoni grupin e synuar dhe tregoni se si ky grup do të përfitojë nga projekti. Ky seksion duhet të japë një përshkrim të madhësisë dhe karakteristikave të grupit të synuar, në veçanti të përfituesve të drejtpërdrejtë të projektit. Bëni dallimin mes përfituesve të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të projektit. Jepni shifra konkrete njerëzish, biznesesh, organizatash etj., bazuar në të dhëna të gjendjes civile, statistikave zyrtare mbajtur nga NJQV-ja juaj apo institucione të tjera. Referohuni gjithmonë statistikave. Nëse është e nevojshme bashkëngjitini informacione shtesë. Ju lutem përshkruani se çfarë ndikimi do të ketë zbatimin e projektit tek gratë, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt dhe si gratë mund të përfitojnë nga zbatimi i këtij projekti.

5. Informacion tjetër (jo më tepër se 0,5 fq.)

Informacion në lidhje me projektin që nuk është dhënë më sipër dhe që ju e konsideroni të dobishëm dhe të rëndësishëm. Nëse mendoni se përsëri mungon informacion i rëndësishëm dhe nuk keni hapësirë të mjaftueshme, ju mund t'i bashkëngjisni dokumente të tjerë apo ilustrime (p.sh foto, harta) formularit të aplikimit. Ju duhet t'i listoni ato më poshtë në listën e shtojcave.

Bashkangjitur këtij dokumenti do të gjeni:

1. Vendimin e Këshillit të NJQV-së që pohon se projekti është prioritet dhe mbështetet nga Këshilli.
2. Konfirmimin që NJQV-ja do të bashkëfinancojë projektin me të paktën 20 % të shumës totale të projektit.
3. Konfirmim që projekti i propozuar është një pronë publike. (kjo nuk është e nevojshme në rastin e projekteve “studimore”)
4. Konfirmim që NJQV-të pjesëmarrëse në projekt njohin rolin kryesor të NJQV-së kryesore në aplikim (vetëm në rastin e projekteve ndërkomunale)
5. ² _____
6. _____

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-së

² Për tu plotësuar në rast se i keni bashkangjitur shtojca të tjera aplikimit.

Shtojca 3 Formulari i aplikimit për fazën e projekt propozimit të plotë

1. Të dhëna të përgjithshme

Aplikanti/ët:	
Personi/at e kontaktit:	
Titulli i projektit	
Vendndodhja	
Buxheti i kërkuar nga dldp-ja	
Kodi i projektit në strategjinë e zhvillimit lokale apo rajonale	
<i>Data e dorëzimit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-së)</i>	
<i>Numri i projektit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-së)</i>	

2. Një përmbledhje e projekt-idesë (jo më tepër se 1 fq.)

--

3. Analiza e situatës (jo më tepër se 2 fq.)

4. Analiza e grupeve që ndikohen nga projekti; Grupet e synuara dhe përfituesit (jo më tepër se 1 fq.)

5. Qëllimi dhe objektivat specifike të projektit (jo më tepër se 1 fq.)

6. Rezultatet e pritshme (jo më tepër se 1 fq.)

Rezultati	Treguesit	Mjetet e verifikimit
Rezultati 1		
Rezultati 2		
Rezultati 3		

7. Aktivitetet e projektit dhe zbatimi (jo më tepër se 3 fq.)

Shembull:

Aktiviteti	Muaji 1	2	3	4	5	6	Organizata përgjegjëse
Prokurimi							NJQV-ja, komisioni i tenderit
Kontraktimi i punimeve							NJQV-ja, Kryetari
Zbatimi i punimeve							Kontraktori, Supervizori
Marrja në dorëzim							NJQV-ja, kontraktori, supervizori
Etj.							

8. Mënyra e organizimit të prokurimit (jo më tepër se 1 fq.)

--

9. Buxheti i projektit (jo më tepër se 2 fq.)

<i>Vlera totale e projektit</i>	<i>1=2+3</i>
<i>Buxheti i kërkuar nga dldp-ja</i>	<i>2</i>
<i>Buxheti i kontribuar nga NJQV-ja</i>	<i>3</i>

10. Rreziqet/Supozimet (jo më tepër se 0.5 fq.)

--

11. Plani i montorimit dhe i vlerësimit (jo më tepër se 0.5 fq.)

--

12. Qëndrueshmëria e projektit (jo më tepër se 2 fq.)

13. Faktorët cilësorë (jo më tepër se 2 fq.)

Ju lutem shpjegoni këtu të mëposhtmet:

- a) **Aspektet gjinore.** A do të kontribuojë projekti në barazinë gjinore dhe si? A ka marrë parasysh projekti interesin e grave? A do të përfshihen apo konsultohen gratë gjatë zbatimit të projektit?

- b) **Transparenca gjatë zbatimit.** Përshkruani se si do të informoni dhe/ose përfshini komunitetin përfitues gjatë zbatimit të projektit.

- c) **Inovacioni.** Nëse ka kuptim (mund ta lini këtë seksion bosh) shpjegoni nëse ideja e projektit tuaj apo metoda e zbatimit apo teknologjia e planifikuar të përdoret, sjell një qasje të re në NJQV-në apo më gjerë në Qarkun tuaj dhe se ka mundësi që kjo ide/metodë të përdoret me sukses në të ardhmen.

14. Të dhëna rreth aplikantit (ëve) (jo më tepër se 2 fq.)

<i>Viti</i>	<i>Buxheti total</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>
2008		
2009		
2010		

<i>Donatori</i>	<i>Titulli projekti dhe një përshkrim i shkurtër</i>	<i>Buxheti</i>	<i>Data e fillimit dhe e mbarimit</i>

Bashkangjitur këtij dokumenti do të gjeni:

1. Vendimi i Këshillit të NJQV-së përkatëse që konfirmon sasinë e parave të rezervuara për bashkëfinancimin e projektit në buxhetin e 2011-s që përbëjnë të paktën 20 % të vlerës totale të projektit.
2. Licencën e projektuesit, projektin teknik e preventivin (në rast investimi) .
3. Vendimin e KRT-së që aprovon projektin (në rast investimi).
4. Leje të tjera që nevojiten para fillimit të punimeve (në rast investimi).
5. Planin për funksionim/mirëmbajtjen e aseteve të krijuara nga projekti (në rast investimi).

6. Termat e referencës për ofruesin e shërbimeve (në rast se projekti është një studim, plan rregullues apo projekt informim/komunikimi).
7. Marrëveshja mes NJQV-ve pjesëmarrëse në projekt, ku janë përcaktuar rolet e përgjegjësitë e secilit partner, ku është caktuar aplikanti kryesor dhe ku është rënë dakord për kontributin e secilës NJQV të përfshirë (në rast projektesh ndërkomunale).
8. ¹ _____
9. _____

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-së

¹ Në rast se ka dokumente të tjerë bashkangjitur

Shtojca 3 1: Udhëzime për plotësimin e formularit të aplikimit për fazën e projekt propozimit të plotë

1. Të dhëna të përgjithshme

Aplikanti/ët:	<i>Emri i NJQV-së, Qarku. Në rast të bashkëpunimit ndërkomunal, listojini të gjitha NJQV-të, duke cilësuar aplikantin kryesor.</i>
Personi/at e kontaktit:	<i>Emri, adresa, numri i telefonit i personit përgjegjës për mbajtjen e kontakteve në lidhje me projektin.</i>
Titulli i projektit	<i>Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konciz dhe t'u referohet objektivave apo aktiviteteve kyçe të projektit.</i>
Vendndodhja	<i>Fshati, lagja, vendndodhja e saktë ku do të zbatohet projekti.</i>
Buxheti i kërkuar nga dldp -ja	<i>Vendosni shumën në Euro ¹</i>
Kodi i projektit në strategjinë e zhvillimit lokale apo rajonale	<i>Nëse strategjia lokale apo rajonale është e organizuar me numër fushash prioritare, programesh e projektesh, ju mund të vendosni këtu kodin që i përket projektit. Shembull: Projekt “Ndërtimi i pikës së grumbullimit të mbeturinave në fshatin XX”. Projekti është pjesë e fushës së shërbimeve (që në strategji ka numrin 3), pastaj brenda fushës së shërbimeve është pjesë e programit të përmirësimit të shërbimit të pastrimit në komunë (që në strategji ka numrin 3.2) pastaj brenda programit është projekti i katërt në këtë program (që në strategji ka numrin 3.2.4) Atëherë kodi i projektit është 3.2.4</i>
<i>Data e dorëzimit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-ja</i>	<i>Ju lutem lini kutinë bosh</i>
<i>Numri i projektit (për tu plotësuar nga stafi i dldp-së</i>	<i>Ju lutem lini kutinë bosh</i>

¹ Nëse buxheti është në Lekë Shqiptare, përdorni kursin ditor zyrtar të këmbimit nga Banka e Shqipërisë

2. Një përmbledhje e projekt-idesë (jo më tepër se 1 fq.)

Përmbledhja duhet të përmbajë:

- Kohëzgjatjen totale të projektit, numrin e muajve të parashikuar për zbatim
- Qëllimin dhe objektivat specifike të projekti në pak rreshta
- NJQV-në zbatuese dhe partnerët e zbatimit (nëse ka të tillë)

- Grupet e synuar dhe përfituesit
- Rezultate e pritshme
- Aktivitetet kryesore

Përmbledhja duhet plotësuar në fund pasi të keni plotësuar të gjithë seksionet e tjera.

3. Analiza e situatës (jo më tepër se 2 fq.)

Ju lutem përshkruani të mëposhtmet:

Rëndësia e projektit të propozuar në lidhje me strategjitë në nivel kombëtar e rajonal. (citoni objektivat e këtyre strategjive, përpikuni të jeni shumë konkret)

Rëndësia e projektit të propozuar në nivel vendor. Bëni një përshkrim të territorit të NJQV-së, sektorit/nënsektorit të projektit tuaj dhe përshkruani planet/programet në nivel vendor për të përmirësuar situatën.

Shpjegoni qartë problemin(et) që është (janë) në qendër të projektit tuaj. Seksioni i shtjellimit të problemit jep një përshkrim të problemit (eve) specifike që projekti përpiqet t'i zgjidhë, në mënyrë që të justifikohet nevoja për këtë projekt. Mbani parasysh se kjo analizë është shumë e rëndësishme dhe duhet të jetë pikënisja e të gjithë projektit.

4. Analiza e grupeve që ndikohen nga projekti; Grupet e synuara dhe përfituesit (jo më tepër se 1 fq.)

Përcaktoni grupin e synuar dhe tregoni se si ky grup do të përfitojë nga projekti. Jepni shifra konkrete njerëzish, biznesesh, organizatash etj., bazuar në të dhëna të gjendjes civile, statistikave zyrtare mbajtur nga NJQV-ja juaj apo institucione të tjera. Referohuni gjithmonë statistikave,. Nëse është e nevojshme bashkëngjitini informacione shtesë. Bëni dallimin mes përfituesve të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të projektit. Ju lutem përshkruani numrin e grave që do të përfitojnë nga projekti dhe raportin me numrin e përgjithshëm të përfituesve.

Ky seksion duhet të japë një përshkrim të madhësisë dhe karakteristikave të nëngrupeve të grupit të synuar dhe të gjithë grupeve që mund të ndikohen nga projekti; si ndikohen ata dhe qëndrimi i mundshëm i tyre ndaj projektit.

5. Qëllimi dhe objektivat specifike të projektit (jo më tepër se 1 fq.)

Kur të formuloni qëllimin e projektit, ju lutem mbani parasysh se realizmi i projektit tuaj kontribuon në arritjen e qëllimit por nuk e arrin drejtpërdrejt atë. Një projekt duhet të ketë vetëm një qëllim. Përshkruani edhe ndërhyrje të tjera shtesë që duhet të ndodhin në mënyrë që të arrihet qëllimi i projektit.

Objektiv/at specifike të projektit duhet tu referohen problemit kryesor të identifikuar dhe duhen shprehur si përfitime nga përfituesit e projektit apo grupi i synuar si një rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes së projektit. Koherenca e të gjithë projekt propozimit është një kriter i rëndësishëm i vlerësimit. Objektivat duhet të përputhen me analizën e problemit.

6. Rezultatet e pritshme (jo më tepër se 1 fq.)

Rezultatet përshkruajnë shërbimet apo produktet që u dorëzohen përfituesve të synuar të projektit. Kjo është ajo çka projekti premtan të dorëzojë. Rezultatet janë më të detajuara se objektivat dhe qëllimi i projektit; ata duhet të jenë të mundshme për tu matur përmes përdorimit të treguesve objektivë. Për secilin nga rezultatet e pritshme jepni treguesit dhe mënyrën e verifikimit të arritjes së tyre. Tregojeni këtë në tabelën e mëposhtme:

Rezultati	Treguesit	Mjetet e verifikimit
Rezultati 1		
Rezultati 2		
Rezultati 3		

7. Aktivitetet e projektit dhe zbatimi (jo më tepër se 3 fq.)

Listoni aktivitetet e projektit në mënyrë kronologjike. Emërtojini ato kronologjikisht: p.sh. aktiviteti 1 (Titulli); Aktiviteti 2 (titulli) dhe përshkruani secilin prej tyre. Përshkruani në detaje kush do t'i kryejë aktivitetet (NJQV-ja, sipërmarrësi, kontraktori, NJQV-ja partnere) kur dhe ku do të zbatohen ato, mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre. Lidhni aktivitetet me rezultatet e pritshme.

Sigurohuni të tregoni që projekti mund të zbatohet realisht brenda 6 muajve. Ky do të jetë një kriter i rëndësishëm vlerësimi.

Pas përshkrimit, përgatitni një plan aktivitetesh në formatin e mëposhtëm. Sigurohuni që titujt e aktiviteteve në plan të korrespondojnë me aktivitetet e përshkruar më parë. Mos përdorini datat konkrete të aktiviteteve por muajin 1,2 etj. për të treguar që ju jeni gati për fillimin e zbatimit në momentin e miratimit të financimit.

Plani i veprimit ka formatin e mëposhtëm:

Shembull:

Aktiviteti	Muaji 1	2	3	4	5	6	Organizata përgjegjëse
Prokurimi							NJQV-ja, komisioni i tenderit
Kontraktimi i punimeve							NJQV-ja, Kryetari
Zbatimi i punimeve							Kontraktori, Supervizori
Marrja në dorëzim							NJQV-ja, kontraktori, supervizori
Etj.							

8. Mënyra e organizimit të prokurimit (jo më tepër se 1 fq.)

Ju lutem përshkruani në këtë seksion organizimin e prokurimit për projektin. Kush do të jetë përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, organizimin e procesit, përshkruani bazën ligjore për organizimin e prokurimit si dhe nëse NJQV-ja juaj ka bërë prokurime të ngjashme në tre vitet e fundit. Për projektet që nuk janë investime, ka rëndësi të veçantë cilësia e ekspertizës teknike të ofruar e metodologjia që do të përdoret (që duhet të jetë në përputhje me përvojat më të mira të dldp-së në këtë drejtim) dhe jo vetëm çmimi i ofruar. Në këto raste, metoda e prokurimit është më komplekse se prokurimi i punimeve apo blerjeve dhe shumë NJQV nuk kanë përvoja të mëparshme në këtë drejtim. Në këto lloj projektesh, nëse gjykoni se keni nevojë për asistencë teknike në hartimin e detajimin e termave të referencës dhe kontratës për këtë shërbim apo nuk keni përvojë të mjaftueshme për organizimin e një prokurimi të tillë mund t'i kërkonti stafit të dldp-së:

- a) Asistencë teknike për hartimin e këtyre dokumenteve.
- b) Delegimin e të gjithë procesit të prokurimit stafit të dldp-së

Në secilin nga dy rastet e përmendura, ju duhet ta shprehni këtë qartë në aplikim dhe kjo mund të bëhet vetëm për projektet që nuk janë investime apo blerje. DLDP-ja rast pas rasti do të vendosë nëse do ta pranojë apo jo delegimin. Në çdo rast stafi i dldp-së do të japë pëlqimin përfundimtar për dokumentet e tenderit.

9. Buxheti i projektit (jo më tepër se 2 fq.)

Jepni një përshkrim të llogaritjes së buxhetit, mënyrës se si u llogaritën kostot, referojuni dokumenteve bashkangjitur (nëse ka) si preventiv i hartuar nga projektuesi; ose referojuni aktiviteteve të ngjashme kryer nga institucioni juaj apo të institucione të tjera në të kaluarën që ju keni përdorur për të llogaritur kostot.

Rroga apo përfitime të tjera për stafin e bashkisë/komunës, shpenzime operative për bashkinë/komunën nuk do të financohen. Në rastin e investimeve, kostot e përgatitjes së projektit teknik janë pjesë e procesit të aplikimit dhe nuk do të rimbursohen nga dldp-ja si pjesë e projektit. Kostot e supervizionit dhe kolaudimit do të paguhen nga NJQV-ja dhe nuk do të konsiderohen si pjesë e bashkëfinancimit. Buxheti duhet të përfshijë taksat. NJQV-ja duhet të bashkëfinancojë të paktën 20 % të vlerës totale të projektit. Bashkëfinancimi duhet të konfirmohet me një vendim të Këshillit të NJQV-së përkatëse që konfirmon sasinë e parave të rezervuara për bashkëfinancimin e projektit në buxhetin e 2011-s.

Vlera totale e projektit	$I=2+3$
Buxheti i kërkuar nga dldp	2
Buxheti i kontribuar nga NJQV-ja	3

Ju lutem futni këtu buxhetin e detajuar apo referojuni dokumenteve të tjera bashkëngjitur që janë pjesë e aplikimit ku buxheti mund të jetë treguar me detaje (p.sh. projekti teknik e preventivi, termat e referencës etj.)

10. Rreziqet/Supozimet (jo më tepër se 0.5 fq.)

Identifikoni këtu rreziqet kryesore që lidhen me zbatimin e projektit dhe mund të ndërhyjnë në një zbatim të suksesshëm të tij.

Gjithashtu përshkruani supozimet, (zakonisht aktivitete jashtë kontrollit tuaj), që mund të ndërhyjnë me zbatimin e suksesshëm të projektit.

Në të dy rastet përshkruani se si parashikoni t'i kapërceni ato.

11. Plani i monitorimit dhe i vlerësimit (jo më tepër se 0.5 fq.)

Si do të masni progresin real ndaj atij të planifikuar?

Si do të siguroheni nëse projekti i ka arritur objektivat e tij specifike?

12. Qëndrueshmëria e projektit (jo më tepër se 2 fq.)

Ju lutem shpjegoni këtu se si do të sigurohet qëndrueshmëria e rezultateve të projektit pas përfundimit të financimit nga dldp-ja.

Tregoni sa më konkretisht planin e qëndrueshmërisë në rrafsh institucional. Si do të integrohen rezultatet e projektit në punën e Bashkisë/komunës suaj, cili nga departamentet do të jetë përgjegjës për këtë?

Tregoni në terma sa më konkretë buxhetin që NJQV-ja juaj ka vënë në dispozicion tre vitet e fundit për aktivitete të ngjashme (mirëmbajtja e aseteve të ngjashme, informacion dhe komunikim, plane e studime; në varësi të projektit të propozuar) dhe tregoni mundësinë buxhetore të NJQV-së suaj për të përfshirë burimet e nevojshme në vitet e ardhshme.

Bëni një llogaritje të hollësishme të buxhetit të nevojitur për qëndrueshmërinë në 5 vitet e ardhshme.

Në rastin e investimeve është absolutisht e detyrueshme të bashkëngjisni një plan konkret për mirëmbajtjen dhe/ose funksionimin e aseteve të krijuara nëpërmjet projektit. Rekomandohet që t'ia kërkonti këtë konsulentit që do të përgatitë projektin teknik.

Qëndrueshmëria është një nga kriteret kryesore për caktimin e projekteve fitues.

13. Faktorët cilësorë (jo më tepër se 2 fq.)

Ju lutem shpjegoni këtu të mëposhtmet:

- d) Aspektet gjinore.** A do të kontribuojë projekti në barazinë gjinore dhe si? A ka marrë parasysh projekti interesin e grave? A do të përfshihen apo konsultohen gratë gjatë zbatimit të projektit?
- e) Transparenca gjatë zbatimit.** Përshkruani se si do të informoni dhe/ose përfshini komunitetin përfitues gjatë zbatimit të projektit.
- f) Inovacioni.** Nëse ka kuptim (mund ta lini këtë seksion bosh) shpjegoni nëse ideja e projektit tuaj apo metoda e zbatimit apo teknologjia e planifikuar të përdoret, sjell një qasje të re në NJQV-në apo më gjerë në Qarkun tuaj dhe se ka mundësi që kjo ide/metodë të përdoret me sukses në të ardhmen.

14. Të dhëna rreth aplikantit (ëve) (jo më tepër se 2 fq.)

Ju lutem përshkruani si më poshtë:

- *Të dhëna të përgjithshme rreth NJQV-së (Territori; popullsia, ekonomia lokale etj.)*
- *Të dhëna për qeverinë vendore. Organizmi i stafit dhe hierarkia, numri i stafit, buxheti i tre viteve të fundit, dhe të ardhurat e veta në tre vitet e fundit (sipas tabelës)*

<i>Viti</i>	<i>Buxheti total</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>
<i>2008</i>		
<i>2009</i>		
<i>2010</i>		

- *Një listë projektesh të një natyre të ngjashme me projektin e propozuar, zbatuar gjatë tre viteve të fundit :*

<i>Donatori</i>	<i>Titulli i projektit dhe një përshkrim i shkurtër</i>	<i>Buxheti</i>	<i>Data e fillimit dhe e mbarimit</i>

Bashkangjitur këtij dokumenti do të gjeni:

1. Vendimi i Këshillit të NJQV-së përkatëse që konfirmon sasinë e parave të rezervuara për bashkëfinancimin e projektit në buxhetin e 2011-s që përbëjnë të paktën 20 % të vlerës totale të projektit.
2. Licencën e projektuesit, projektin teknik e preventivin (në rast investimi).
3. Vendimin e KRT-së që aprovon projektin (në rast investimi).
4. Leje të tjera që nevojiten para fillimit të punimeve (në rast investimi).
5. Planin për funksionim/mirëmbajtjen e aseteve të krijuara nga projekti (në rast investimi).
6. Termat e referencës për ofruesin e shërbimeve (në rast se projekti është një studim, plan rregullues apo projekt informim/komunikimi).
7. Marrëveshja mes NJQV-ve pjesëmarrëse në projekt, ku janë përcaktuar rolet e përgjegjësitë e secilit partner, ku është caktuar aplikanti kryesor dhe ku është rënë dakord për kontributin e secilës NJQV të përfshirë (në rast projektesh ndërkomunale).
8. ² _____

² Në rast se ka dokumente të tjerë bashkangjitur

9. _____

Konfirmoj se informacioni i dhënë në dokumentet e këtij aplikimi është i saktë.

Sinqerisht,

Emri, Mbiemri, firma e titullarit të NJQV-së, vula e NJQV-së

Shtojca 4: Termat e referencës dhe kërkesat për vlerësuesit e pavarur

A. Të përgjithshme

Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (dldp) në Qarqet e Shkodrës dhe Lezhës është një program i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim e Zhvillim dhe i zbatuar nga INTERCOOPERATION, Fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Dldp-ja, si pjesë e programit synon të ngrejë një skemë me fonde grant, nëpërmjet së cilës do të mbështesë NJQV-të partnere në përmirësime konkrete në shërbime publike dhe infrastrukturë, studime fizibiliteti, aktivitete informimi/komunikimi, përpunim studimesh dhe promovim të bashkëpunimit ndër-komunal.

Fondi grant duhet të shërbejë si një “fushë trajnimi e testimi” për NJQV-të në zonën e projektit për vendim-marrje transparente e me pjesëmarrje dhe menaxhim projektsh. Granti gjithashtu duhet tu mundësojë NJQV-ve të përfshira të aksesojë fonde të tjera në nivel rajonal e kombëtar.

Do të publikohen dy thirrje për aplikime (shtator 2010 dhe fundi i vitit 2011). Vendim-marrja për përzgjedhjen e projekteve për financim do të bëhet mbi baza konkurrimi, bazuar në ndikimet e pritshme, rëndësinë ndaj qëllimeve të programit dhe cilësinë e projekteve të propozuara.

Përzgjedhja do të bëhet në dy faza, në fazën e parë, NJQV-të do të përgatisin konceptet e projekteve; bazuar në vlerësimin e tyre do të përzgjidhen rreth 20 projekte.

Në fazën e dytë, NJQV-ve të kualifikuara do tu kërkohet të dorëzojnë projekt-propozimet e plota, përfshirë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor (si projekti teknik, termat e referencës, planet e menaxhimit etj.) që të sigurohet gatishmëria e projekteve për financim.

Për të dy fazat janë përgatitur formularë standardë të aplikimit dhe kritere të përzgjedhjes. Këto kritere dhe një përshkrim i detajuar i mekanizmit të shpërndarjes së grantit janë pjesë e manualit që gjendet bashkangjitur këtyre termave¹.

B. Qëllimi dhe objektivat e punës

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj detyre është vlerësimi i projekt propozimeve të plota të sjella nga NJQV-të e Qarqeve Shkodër dhe Lezhë.

Stafi i dldp-së dëshiron të kontraktojë tre ekspertë të jashtëm për vlerësimin e propozimeve.

Detyrat e konsulentit përfshijnë të mëposhtmet:

1. Lexim i kujdesshëm i të gjithë projekteve dorëzuar nga NJQV-të.
2. Vendos nëse të gjithë propozimet përmbushin kriteret e detyrueshme dhe regjistrim i arsyeve për refuzimin e tyre.
3. Vlerësim i të gjithë projekt-propozimeve të kualifikuara bazuar në kriteret e vlerësimit dhe mbajtja e shënimeve rreth pikëve të forta e të dobëta të çdo projekti.
4. Nëse është e nevojshme dhe kërkohet nga dldp-ja, në rast paqartësish, mund të jenë të nevojshme një numër i kufizuar (2-3 ditë) ditësh verifikimi në terren.
5. Dorëzimi në kohë i formateve të raportimit për çdo projekt dhe një tablele të përgjithshme me pikëzimin e kriterëve për çdo propozim.
6. Diskuton me vlerësuesit e tjerë dhe stafin e dldp-së, pikët e dobëta dhe të forta të çdo propozimi.
7. Çdo vlerësues do të japë pikëzimin e vet individualisht, dhe diferencat mes vlerësimeve do të diskutohen mes vlerësuesve në një mbledhje mes vlerësuesve dhe stafit të dldp. Nëse është e mundur, gjatë diskutimit këta diferenca sheshohen dhe të tre vlerësuesit dalin me të njëjtin vlerësim.
8. Nëse diferencat në vlerësim janë të konsiderueshme edhe pas diskutimeve, atëherë do të mbahen vlerësimet e të gjithë vlerësuesve dhe pikëzimi mesatar do të shkojë për miratim tek donatori, SDC-ja.

¹ Shih bashkangjitur Shtojca 1 “Udhëzuesi për shpërndarjen dhe menaxhimin e fondit grant të dldp”

Në këtë fazë do të vlerësohen rreth 20 projekt-propozime. Nëse kërkohet nga klienti, vlerësuesit duhet të marrin pjesë në takime me donatorin apo në mbledhje me bordin drejtues për të shpjeguar mënyrën e përdorimit të kriterëve.

C. Produket dhe afatet kohore:

Një raport që përmban formatet e plotësuara të raportimit për çdo projekt-propozim, duke përfshirë komentet të shkruara si dhe një tabelë me të përgjithshme me pikëzimin e kriterëve për çdo projekt, duhet t'i dorëzohet donatorit, SCO-AI, brenda 10 ditëve punë nga marrja e projekteve. Nëse është e nevojshme, komentet e donatorit duhen reflektuar në një raport të përmirësuar.

D. Mbështetja e dldp-së për konsulentin

Stafi i dldp-së do të veprojë si ndërlidhës mes konsulentit, Njësive të Qeverisjes Vendore dhe donatorit. Dldp-ja do të shpërndajë në kohë projekt-propozimet e plota në format të shtypur dhe elektronik. Dldp-a, nëse është e nevojshme, do të bëjë një prezantim të projektit për të familjarizuar konsulentin me qëllimet e përgjithshme të projektit dhe më në veçanti në lidhje me objektivat, metodologjinë, kriteret, aktorët e përfshirë dhe përgjegjësitë e secilës palë në fondin grant. Konsulenti duhet të ketë zyrën dhe pajisjet e tij.

E. Kualifikimet e nevojshme

Konsulenti lokal duhet të dorëzojë CV-në e tij duke vënë në dukje studime apo raportime në fusha të ngjashme me detyrat e kërkuara.

Grupi i vlerësuesve duhet të ketë një përbërje prej tre ekspertësh me kërkesat e mëposhtme specifike:

Kualifikimet (1. Inxhinier ndërtimi)

Përvoja e kërkuar:

- **Diplomë në inxhinieri ndërtimi**
- **Të paktën pesë vjet pune përvojë si inxhinier**
- **Përvojë në vlerësim, projektim e supervizion të projekteve të vogla të infrastrukturës komunale/bashkiake.**
- **Njohuri dhe përvojë pune me Njësitë e Qeverisjes Vendore**
- **Njohuri rreth ciklit të menaxhimit të projektit.**
- Aftësi komunikimi me shkrim dhe raportim në kohë.
- Preferohet përvojë e mëparshme në Qarqet e Projektit.
- Preferohet diplomë Master apo kualifikime të tjera në inxhinieri apo fusha të tjera të lidhura me detyrat e kërkuara.

Kualifikimet (2. Ekspert i Qeverisjes Vendore/Ofrimit të Shërbimeve lokale)

Përvoja e kërkuar:

- **Diplomë në inxhinieri, planifikim urban, drejtësi apo ekonomi**
- **Të paktën pesë vite përvojë pune me Njësitë e Qeverisjes Vendore**
- **Përvojë e mëparshme pune në shërbime publike lokale, studime fizibiliteti, plane të zhvillimit lokal, planifikim urban etj.**
- **Përvojë e mëparshme në vlerësimin e projekteve në skema konkurruese**
- **Njohuri të plota rreth ciklit të menaxhimit të projekteve**
- **Përvojë në projekte të financuara nga donatorë ndërkombëtarë**
- Aftësi të komunikimit me shkrim dhe raportim në kohë

- Preferohet përvojë e mëparshme në Qarqet e Projektit
- Preferohet diplomë Master apo kualifikime të tjera në fushat e shërbimeve publike, qeverisjes vendore, menaxhimit të projektit apo fusha të tjera të lidhura me detyrat e kërkuara

Kualifikimet (3. Ekspert në vlerësimin e ndikimit social-ekonomik)

Përvoja e kërkuar:

- **Diplomë në shkencë sociale apo ekonomi**
- **Të paktën pesë vite përvojë pune me Njësitë e Qeverisjes Vendore**
- **Përvojë e mëparshme në vlerësimin e ndikimit, studime fizibiliteti, përgatitjen e planeve apo profileve të komuniteteve lokale, pjesëmarrjeje në nivel lokal apo projekte të qeverisjes së mirë në nivel vendor.**
- **Përvojë e mëparshme në vlerësimin e projekteve në skema konkurruese**
- **Njohuri të plota rreth ciklit të menaxhimit të projekteve.**
- **Përvojë në projekte të financuara nga donatorë ndërkombëtarë**
- Aftësi të komunikimit me shkrim dhe raportim në kohë.
- Preferohet përvojë e mëparshme në Qarqet e Projektit
- Preferohet diplomë Master apo kualifikime të tjera në ekonomi, qeverisje vendore, menaxhim projekti apo fusha të tjera të lidhura me detyrat e kërkuara.

F. Të tjera

Konsulenti duhet të tregojë paanësi dhe transparencë në vlerësimin e projekt-propozimeve të ndryshme dhe nuk duhet të ketë konflikt interesi në vlerësim (p.sh punon në ndonjërin nga NJQV-të aplikante apo ka qenë pjesë e formulimit të projekt-propozimit nga NJQV-të).

Vlerësimet duhet të jenë konfidenciale dhe asnjë informacion në lidhje me projektin nuk mund të bëhet publik pa lejen me shkrim nga stafi i dldp-së.


**Shtojca 5: Procesi i vlerësimit dhe kriteret që do të përdoren në dy fazat e aplikimit dhe për
përzgjedhjen e projektit më të mirë:**

Përmbledhje

Kriteret e përzgjedhjes do të jenë të detyrueshme dhe vlerësuese. Kriteret e detyrueshme do të përdoren në fazën e parë të vlerësimit. DLDP do të vlerësojë nëse konceptet e projekteve përmbushin kriteret e detyrueshme. Pastaj, çdo koncept-projekt do të vlerësohet nga kriteret vlerësuese, dhe bazuar në renditjen e pikëve dhe fondin në dispozicion, do të vendoset për listën e projekteve që do të kualifikohen për fazën e dytë të konkurrimit.

Në fazën e dytë të konkurrimit kriteret vlerësuese do të përdoren për të renditur projektet dhe për të vendosur cili projekt do të financohet. Në këtë dokument janë listuar kriteret që do të përdoren në të dy fazat e konkurrimit, nga ekspertët e Qarqeve respektive dhe nga vlerësuesit e pavarur.

Fig 1. “Skema e vlerësimit të projekteve”



Pas zbatimit të projekteve gjatë raundit të parë të zbatimit të fondit grant, do të përzgjidhet projekti më i mirë. NJQV-ja që ka zbatuar projektin më të mirë do të ketë mundësinë e financimit të një projekti tjetër që përputhet me kriteret e financimit të udhëzuesit.

1. Kriteret dhe procesi i përzgjedhjes për në fazën e parë të koncept-projekteve:

I. KRITERE TË DETYRUESHME:

- A) Projekti i propozuar është një funksion i drejtpërdrejtë i Njesisë së Qeverisjes Vendore.
- B) Projekti dorëzohet brenda afatit kohor.
- C) Projekti i propozuar nuk është një projekt i pjesshëm.
- D) Konfirmimi që NJQV-ja do të paguajë 20 % të vlerës totale të projektit si bashkëfinancim.
- E) Ka një vendim të Këshillit të NJQV-së që projekti është prioritet.
- F) Konfirmim për çështje të pronësisë.

II. KRITERET E VLERËSIMIT:

Një projekt mund të arrijë një maksimum prej 100 pikësh (80 + 20 pikë në rastin e projekteve ndërkomunale).

A. Kriteret institucionale dhe të qeverisjes së mirë. (40 pikë)

- 1. Harmonizimi me strategjinë lokale apo rajonale (0 deri në 10 pikë)
- 2. Cilësia e/kohezioni i përmbajtjes së propozimit përfshirë formën e prezantimit (0 deri në 15 pikë)
- 3. Kontributi në efektivitetin e qeverisjes (0 deri në 10 pikë)
- 4. Kontributi në transparencën e qeverisjes vendore (0 deri në 5 pikë)

B. Kriteria social-ekonomike (40 pikë)

- 1. Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë (0 deri në 10 pikë)
- 2. Ndikimi i pritshëm në sektorët ekonomikë (0 deri në 5 pikë)
- 3. Shkalla e varfërisë e NJQV-së (0 deri në 5 pikë)
- 4. Orientimi drejt grupeve në nevojë (0 deri në 5 pikë)
- 5. Orientimi drejt grave (0 deri në 5 pikë)
- 6. Nevoja e menjëhershme për projektin (0 deri në 5 pikë)

C. Bashkëpunimi ndër-komunal (20 pikë)

- 1. Bashkëpunimi ndërmjet NJQV-ve për të sjellë projekte të përbashkëta. (0 deri në 20 pikë)

III. ETAPAT E PROCESIT:

- A) Dldp informon NJQV për procesin dhe kriteret e aplikimit në fondin me bashkëfinancim të dldp.
- B) Eksperti i angazhuar nga dldp-ja trajnon përfaqësuesit e NJQV-së në modulën “Shkrimi i projekt ideve”.
- C) Eksperti i angazhuar nga dldp-ja informon ekspertët e Qarqeve dhe konsulentët e projektit për mënyrën e vlerësimit të projekteve me pikëzim sipas kriterëve të aprovuara nga SCO-AL.
- D) Staf i dldp-së pranon aplikimet e ardhura nga NJQV-të deri në afatin e përcaktuar.
- E) Staf i dldp-së verifikon aplikimet e sjella nëse ata përmbushin kriteret e detyrueshme. Staf i dldp-së përcjell për vlerësim tek ekspertët e Qarqeve dhe tek konsulentët e angazhuar nga projekti sipas fushave përkatëse projektet që përmbushin kriteret e detyrueshme.
- F) Ekspertët e të dy Qarqeve vlerësojnë të gjithë projekt-konceptet e ardhura nga të dy Qarqet dhe shkëmbejnë mendim para vendosjes finale të pikëve. Ekspertët e Qarqeve japin një vlerësim të përbashkët për pikëzimin e secilit projekt.
- G) Konsulentët e angazhuar nga projekti bëjnë gjithashtu vlerësimin me pikë të projekteve sipas formatit përkatës bazuar edhe në përvojën e tyre të mëparshme sipas fushave përkatëse të ekspertizës.
- H) Staf i dldp-së lehtëson diskutimet mes konsulentëve të projektit dhe ekspertëve të Qarqeve për dallimet në pikëzim mes dy vlerësimeve. Grupi i ekspertëve të Qarkut delegon dy përfaqësues (një për secilin Qark) dhe grupi i ekspertëve të pavarur një përfaqësues në takimin negociues që mbahet në rast diferencash të mëdha mes pikëzimit të Qarqeve dhe grupit të ekspertëve. Përfaqësuesit zgjidhen përpara fillimit të vlerësimit dhe mandatohen me rol vendimmarrës. Nëse është e mundur, gjatë diskutimit këta diferenca sheshohen dhe të dy palët dalin me të njëjtin vlerësim.
- I) Nëse diferencat në vlerësim janë të konsiderueshme edhe pas diskutimeve, atëherë do të mbahen vlerësimet e të dy palëve dhe pikëzimi mesatar do të shkojë për miratim tek donatori, SCO-AL.
- J) Eksperti i angazhuar nga dldp-ja do të jetë përgjegjës për hartimin e raportit për t’u dërguar tek donatori. Raporti do të përmbajë një seksion narrativ ku të përshkruhet procesi deri në këtë moment si dhe tabela me rezultatin e përmbledhur të projekteve dhe me anekset përkatëse për vlerësimin e çdo projekti.
- K) Donatori, SCO-AL, ka të drejtë ta miratojë raportin siç është ose të kërkojë sqarime të tjera për të. Komentet e SCO-AL janë të detyrueshme për t’u reflektuar nga palët e tjera. Vendimi i SCO-AL njihet që përzgjedhja është një proces i mbështetur në manualin e aprovuar nga SCO-AL.
- L) Staf i DLDP-së asiston donatorin SCO-AL për ndarjen e buxhetit sipas linjave të projektit. Mbi këtë bazë, SCO-AL merr vendimin përfundimtar për miratimin e listës së projekteve në konsultim me Bordin Drejtues të projektit.
- M) Pas marrjes së vendimit final, konsulentët e angazhuar nga projekti sipas fushave përkatëse u japin rekomandime NJQV-ve të kualifikuara për përmirësime para paraqitjes së projekt-propozimit final.
- N) Dldp informon të gjithë NJQV-të pjesëmarrëse për rezultatin e vlerësimit.

IV. AKTORËT E PROCESIT:

- **NJQV-Njësitë** e Qeverisjes Vendore paraqesin projekt-konceptet tek dldp-ja.
- **Stafi i dldp-së**, Stafi i Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal pranon aplikimet nga NJQV-të, verifikon nëse ato përmbushin kriteret e detyrueshme, lehtëson të gjithë procesin e koordinimit mes aktorëve, asiston donatorin për vendim-marrjen finale sidomos në kuadrin e shpërndarjes së buxhetit për linjë projektesh.
- **Ekspertët e Qarkut**- Qarku Shkodër dhe Qarku Lezhë ngrenë nga një grup prej tre ekspertësh të kryesuar nga Drejtorët e Departamenteve përkatëse të Zhvillimit. Përgjegjësia e tyre përfshin leximin me kujdes dhe vlerësimin me pikë të të gjithë projekteve të ardhura nga NJQV-të e të dy Qarqeve, diskutimin me konsulentët e angazhuar nga projekti me qëllim arritjen e një vlerësimi të përbashkët.
- **Konsulentët e Angazhuar nga Projekti**- janë organizatat e angazhuara në kuadër të projektit me ekspertizë të konfirmuar në fushat e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe planifikimit urban etj. (Co-Plan), Informacionit e komunikimit dhe one stop shops (FLAG), shërbime publike (URI). Përgjegjësitë e tyre përfshijnë leximin me kujdes dhe vlerësimin me pikë të koncept-projekteve, diskutimin me ekspertët e qarkut me qëllim arritjen e një vlerësimi të përbashkët dhe dhënien e rekomandimeve sipas fushave të ekspertizës për NJQV-të e kualifikuara për në fazën e dytë për përmirësimin e mundshëm para sjelljes së projekt-propozimeve të plota.
- **Donatori**¹-SCO-AL si donatori i projektit do të ketë peshën kryesore të vendim-marrjes në këtë proces. Do të pranojë raportin e procesit dhe do të vendosë të miratojë procesin duke rezervuar të drejtën për sqarime të mëtejshme apo komente. Vendos për miratimin e listës që kalon për në fazën e dytë të përgatitjes së projekt-propozimeve të plota, bazuar në inputet e stafit të dldp-së. SCO-Al para marrjes së vendimit final do të konsultojë edhe bordin drejtues të projektit. SCO-Al ka të drejtën e vetos.
- **Bordi Drejtues**- i projektit është një bord i përbërë nga aktorët kryesorë të projektit, Kryetarët e Qarqeve, Shoqatat e Bashkive/komunave, donatorë të tjerë, shoqëri civile. Në këtë raund aplikimesh, ky bord do të ketë rol konsultativ me qëllim forcimin e rolit të tij në vendim-marrjen e procesit në raundin e ardhshëm dhe dhënien e inputeve për përmirësimin e procedurave. Bordi ka të drejtë të bëjë komente mbi raportin përmbledhës, në funksion të përmirësimit të procesit në raundin e ardhshëm.

¹ Gjatë raundit të parë pilot

2. Kriteret dhe procesi i përzgjedhjes për në fazën e projekt propozimeve të plota:

Kriteret e përzgjedhjes në këtë fazë janë vetëm kritere vlerësuese ku një projekt mund të vlerësohet me maksimumi 100 pikë. Bazuar në pikëzimin, do të bëhet një renditje e projekteve dhe do të financohen projektet me pikët më të larta.

Megjithëse në këtë fazë nuk ka kritere të detyrueshme, meqenëse pritet që ato të përmbushen në fazën e parë, disa nga kriteret e përshkruara më poshtë mund të skualifikojnë një projekt propozim të plotë. Këto kritere janë:

- NJQV-ja nuk ka prezantuar dokumentacionin e nevojshëm teknik (si p.sh: projektet teknike, preventivat, buxhetin, termat e referencës)
- NJQV-ja nuk ka marrë parasysh aspektet gjinore në projekt-propozim
- Projekt-propozimi i plotë ka marrë më pak se 20 pikë në kriterin B (Cilësitë teknike të projekt-propozimit të plotë) duke dështuar në plotësimin e standardeve minimale që dokumentacioni i projektit të jetë i gatshëm për zbatim.

I. KRITERET VLERËSUESE

A. Kapacitetet financiare dhe menaxhuese të aplikantit: (20 pikë)

1. Vlera e bashkëfinancimit (0 deri në 10 pikë)
2. Përvoja në menaxhimin e projekteve të ngjashme (0 deri në 10 pikë)

B. Cilësitë teknike të projekt-propozimeve të plota (40 pikë)

2. Cilësia e përmbajtjes së projekt-propozimit (0 deri në 10 pikë)
3. Cilësia e prezantimit të projekt-propozimit të plotë (0 deri në 5 pikë)
4. Cilësitë e dokumentacionit mbështetës (0 deri në 15 pikë)
5. Buxheti edhe efektiviteti i kostos (10 pikë)

C. Qëndrueshmëria e projektit (20 pikë)

1. A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme institucionalisht? (0 deri në 10 pikë)
2. A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme financiarisht? (0 deri në 10 pikë)

D. Aspekte të vlerës së shtuar që sjell projekt-propozimi i plotë (20pikë)

1. Përfshirja e aspektit gjinor në projekt (0 deri në 10 pikë)
2. Inovacioni (0 ose 5 pikë)
3. Transparenca gjatë zbatimit (0 deri në 5 pikë)

II. ETAPAT E PROCESIT:

- A) Staf i dldp-së organizon procesin e kontraktimit të ekspertëve të pavarur për vlerësimin e projekt-propozimeve të plota
- B) Ekspertët e përzgjedhur miratohen nga donatori, SCO-AL.
- C) Dldp-ja përmes ekspertëve të specializuar ofron trajnime në modulën “Shkrimi i projekt-propozimeve” për NJQV-të e kualifikuara (trajnimet janë të hapura edhe për NJQV-të e tjera) dhe prezanton procesin në fazën e dytë të aplikimit.
- D) Dldp-ja organizon seminare tematike, nëse e shih të nevojshme për shpjegimin e rekomandimeve teknike në fusha specifike të projekt ideve.
- E) Staf i dldp-së pranon aplikimet e ardhura nga NJQV-të deri në afatin e përcaktuar.
- F) Staf i dldp-së dhe ekspertët e angazhuar prej tij organizojnë një takim informues me ekspertët e pavarur për përdorimin e kriterëve për vlerësimin e projekt-propozimeve të plota.
- G) Staf i dldp-së përcjell për vlerësim tek ekspertët e pavarur projektet e sjella nga NJQV-të të kualifikuara në fazën e parë.
- H) Ekspertët e pavarur vlerësojnë individualisht të gjithë projektet e dorëzuara me pikë sipas kriterëve të miratuara. Nëse është e nevojshme stafi i dldp-së siguron organizimin e vizitave në terren në rastin e projekteve për të cilët ka pasiguri për të dhënat.
- I) Staf i dldp-së lehtëson diskutimet mes ekspertëve të pavarur për dallimet në pikëzime mes vlerësimeve. Nëse është e mundur, gjatë diskutimit këto diferencë sheshohen dhe palët dalin me të njëjtin vlerësim.
- J) Nëse diferencat në vlerësim janë të konsiderueshme edhe pas diskutimeve, atëherë do të mbahen vlerësimet e të tre ekspertëve dhe pikëzimi mesatar do të shkojë për miratim tek donatori, SCO-AL. Nëse vendoset për skualifikimin e projekteve për shkak të mosplotësisimit të kriterëve të detyruara, ekspertët janë të detyruar të raportojnë hollësisht për arsyet e këtij vendimi.
- K) Eksperti i angazhuar nga dldp-ja do të jetë përgjegjës për hartimin e raportit për tu dërguar tek donatori. Raporti do të përmbajë një seksion narrativ ku të përshkruhet procesi deri në këtë moment si dhe tabela me rezultatin e përmbledhur të projekteve dhe me anekset përkatëse për vlerësimin e çdo projekti.
- L) Donatori, SCO-AL, ka të drejtë ta miratojë raportin siç është ose të kërkojë sqarime të tjera për të. Komentet e SCO-AL janë të detyrueshme për tu reflektuar nga palët e tjera. Vendimi i SCO-AL njihet që përzgjedhja është një proces i mbështetur në manualin e aprovuar nga SCO-AL.

- M) Staf i dldp-së asiston donatorin SCO-AL për ndarjen e buxhetit sipas linjave të projektit. Mbi këtë bazë, SCO-AL merr vendimin përfundimtar për miratimin e projekteve për tu financuar në konsultim me Bordin Drejtues të projektit.
- N) Pas marrjes së vendimit final, konsulentët e angazhuar nga projekti sipas fushave përkatëse u japin rekomandime NJQV-ve fituese për përmirësime nëse është e nevojshme para nënshkrimit të marrëveshjes.
- O) Staf i dldp-së njofton të gjithë NJQV-të pjesëmarrëse për rezultatet e aplikimit.

III. AKTORËT E PROCESIT:

- **NJQV**-Njësitë e Qeverisjes Vendore paraqesin projekt propozimet e plota tek dldp-ja brenda afatit të njoftuar.
- **Stafi i dldp-së** - Staf i Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal pranon aplikimet nga NJQV-të, lehtëson të gjithë procesin e koordinimit mes aktorëve, asiston donatorin për vendim-marrjen finale sidomos në kuadrin e shpërndarjes së buxhetit për linjë projektsh.
- **Ekspertët e Pavarur** - Një grup prej tre ekspertësh të pavarur angazhohen nga stafi i dldp-së për vlerësimin përfundimtar të projekteve. Ata janë përgjegjës për vlerësimin dhe pikëzimin e projekteve sipas kriterëve të rëna dakord. Ekspertët do të punojnë fillimisht të pavarur për pikëzimin e projekteve. Pas pikëzimit fillestar, ekspertët me facilitimin e stafit të dldp-së punojnë së bashku për të pajtuar diferencat në pikëzime. Nëse kjo është e pamundur, atëherë pikëzimi final reflekton mesataren e të tre vlerësimeve.
- **Konsulentët e Angazhuar nga Projekti** - janë organizatat e angazhuara në kuadër të projektit. Ata do të jenë përgjegjës për mbajtjen e seminareve tematike për NJQV-të për përmirësimin e projekt-ideve në projekt-propozime, për trajnimin e NJQV-ve për shkrimin e projekt propozimeve të plota, trajnimin e ekspertëve të pavarur për vlerësimin e projekteve dhe konsolidimin e raportit për donatorin.
- **Donatori**²-SCO-AL si donatori i projektit do të ketë peshën kryesore të vendim-marrjes në këtë proces. Do të pranojë raportin e procesit dhe do të vendosë të miratojë procesin duke rezervuar të drejtën për sqarime të mëtejshme apo komente. Vendos për miratimin e listës finale të projekteve për tu financuar, bazuar në inputet e stafit të dldp-së të ndarjes së buxhetit për linjë aktivitetesh. SCO-Al para marrjes së vendimit final do të konsultohet edhe me bordin drejtues të projektit. SCO-Al ka të drejtën e vetos.
- **Bordi Drejtues** - i projektit është një bord i përbërë nga aktorët kryesorë të projektit, Kryetarët e Qarqeve, Shoqatat e Bashkive/komunave, donatorë të tjerë, shoqëri civile. Në këtë raund aplikimesh, ky bord do të ketë rol konsultativ me qëllim forcimin e rolit të tij në vendim-marrjen e procesit në raundin e ardhshëm dhe dhënien e inputeve për përmirësimin e procedurave. Bordi ka të drejtë të bëjë komente mbi raportin përmbledhës, në funksion të përmirësimit të procesit në raundin e ardhshëm.

² Gjatë raundit të parë pilot.

3. Kriteret dhe procesi i përzgjedhjes për projektin më të mirë

Pas zbatimit të projekteve gjatë raundit të parë të zbatimit të fondit grant, do të përzgjidhet projekti më i mirë. NJQV-ja që ka zbatuar projektin më të mirë do të ketë mundësinë e financimit të një projekti tjetër që përputhet me kriteret e financimit të udhëzuesit. Projekti më i mirë do të përzgjidhet nga bordi drejtues i projektit bazuar në disa kritere që do të vlerësojnë performancën e të gjithë projekteve të zbatuara.

I. KRITERET VLERËSUESE

- Cilësia dhe afatet e zbatimit të projektit. **(40 %)**

Indikatorë kryesorë për matjen e këtij kriteri do të jenë:

- Respektimi i afateve të zbatimit të projektit
- Cilësia e zbatimit bazuar në raportet e supervizionit

- Cilësia e raportimit. **(20%)**

- Dorëzimi i të gjithë raporteve sipas afateve.
- Cilësia dhe sasia e informacionit dhënë në raporte.

- Cilësia e pjesëmarrjes së komuniteteve përfituese gjatë projektit. **(20%)**

- Informimi i qytetarëve gjatë zbatimit të projektit.
- Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e komunitetit gjatë zbatimit të projektit (p.sh dhënia e sugjerimeve për përmirësimin e projektit).

- Vizibiliteti i projektit në median lokale e qendrore. **(20%)**

- Numri i artikujve në shtypin e shkruar me mbulim pozitiv rreth zbatimit të projektit.
- Numri i emisioneve në median elektronike me mbulim pozitiv rreth zbatimit të projektit
- Rëndësia e mediave që kanë publikuar rreth zbatimit të projektit.

II. ETAPAT E PROCESIT:

- A) Kriteret e vlerësimit të projektit më të mirë u bëhen të ditura të gjitha NJQV-ve përfituese që në fillim të zbatimit të projekteve.
- B) Në raportin përfundimtar të projektit, NJQV-të raportojnë edhe në lidhje me indikatorët e vlerësimit për projektin më të mirë.
- C) Eksperti i ngarkuar për trajnimin në menaxhimin e ciklit të projektit, përgatit një raport të shkurtër për secilin projekt duke patur parasysh kriteret por në veçanti për cilësinë e zbatimit të projektit dhe cilësinë e raportimit bazuar në raportet e supervizionit teknik dhe rregullsisë e cilësisë së raportimeve.
- D) Secili nga anëtarët e bordit bazuar në raportet nga NJQV-të dhe lehtësuar nga eksperti i ngarkuar për trajnimin në menaxhimin e ciklit të projektit bën një vlerësim për secilin nga projektet dhe përzgjedh tre projektet më të mira. Tre projektet e votuara më tepër nga anëtarët e bordit janë projektet kandidate për projektin më të mirë.
- E) Staf i dldp-së dhe NJQV-të kandidate organizojnë një vizitë në terren në secilin nga tre projektet për anëtarët e bordit drejtues për të parë nga afër rezultatet e të tre projekteve.
- F) Bazuar në të dhënat e mbledhura në terren, anëtarët e bordit votojnë për projektin më të mirë, dhe projekti me pikët më të larta shpallet fitues.
- G) NJQV-ja me projektin më të mirë përgatit një projekt-propozim të ri që do të financohet nga programi me kusht që tu përmbahet të gjithë kërkesave të fondit grant.

id_prefecture	id_district	id_comune	DISTRICT	COMUNE	FGT0_est
9	18	1	KURBIN	FUSHE KUQE	15.15%
9	18	2	KURBIN	LAÇ	13.11%
9	18	3	KURBIN	MAMURRAS	15.77%
9	18	4	KURBIN	MILOT	15.44%
9	19	1	LEZHE	BALLDRENI I RI	16.47%
9	19	2	LEZHE	BLINISHT	12.37%
9	19	3	LEZHE	DAJÇ	14.09%
9	19	4	LEZHE	KALLMET I MADH	16.99%
9	19	5	LEZHE	KOLÇ	14.50%
9	19	6	LEZHE	LEZHE	13.11%
9	19	7	LEZHE	SHENGJIN	9.54%
9	19	8	LEZHE	SHENKOLL	17.51%
9	19	9	LEZHE	UNGREJ	20.66%
9	19	10	LEZHE	ZEJMEN	13.66%
10	22	1	MADHE MALESI E	GRUEMIRE	9.64%
10	22	2	MADHE MALESI E	KASTRAT	13.41%
10	22	3	MADHE MALESI E	KELMEND	26.87%
10	22	4	MADHE MALESI E	KOPLIK	34.82%
10	22	5	MADHE MALESI E	QENDER	6.05%
10	22	6	MADHE	SHKREL	18.39%
9	25	1	MIRDITE	FANE	35.81%
9	25	2	MIRDITE	KAÇINAR	28.14%
9	25	3	MIRDITE	KTHELLE	25.59%
9	25	4	MIRDITE	OROSH	30.40%
9	25	5	MIRDITE	RRESHEN	20.16%
9	25	6	MIRDITE	RUBIK	16.14%
9	25	7	MIRDITE	SELITE	31.96%
10	29	1	PUKE	BLERIM	33.15%
10	29	2	PUKE	FIERZE	37.56%
10	29	3	PUKE	FUSHE ARREZ	46.08%
10	29	4	PUKE	GJEGJAN	33.41%
10	29	5	PUKE	IBALLE	35.47%
10	29	6	PUKE	PUKE	25.31%
10	29	7	PUKE	QELEZ	29.36%
10	29	8	PUKE	QERRET	27.74%

10	29	9	PUKE	QAFE MAL	30.52%
10	29	10	PUKE	RRAPE	21.78%
10	32	1	SHKODER	ANA E MALIT	9.12%
10	32	2	SHKODER	BERDICE	9.33%
10	32	3	SHKODER	BUSHAT	8.87%
10	32	4	SHKODER	DAJC	6.06%
10	32	5	SHKODER	GURI I ZI	19.27%
10	32	6	SHKODER	HAJMEL	21.26%
10	32	7	SHKODER	VAU DEJES	25.18%
10	32	8	SHKODER	POSTRIBE	8.86%
10	32	9	SHKODER	PULT	28.01%
10	32	10	SHKODER	RRETHINAT	12.54%
10	32	11	SHKODER	SHALE	38.49%
10	32	12	SHKODER	SHKODER	19.82%
10	32	13	SHKODER	SHLLAK	25.65%
10	32	14	SHKODER	SHOSH	28.45%
10	32	15	SHKODER	VELIPOJE	11.60%
10	32	16	SHKODER	VIG MNELLE	27.21%
10	32	17	SHKODER	BARBULLUSH	8.42%
10	32	18	SHKODER	TEMAL	44.72%

Shtojca 5 1: Udhëzim për përdorimin e kritereve për vlerësuesit në fazën e koncepteve të projekteve:

KRITERE TË DETYRUESHME:

A) Projekti i propozuar është një funksion i drejtpërdrejtë i Njesisë së Qeverisjes Vendore

Duhet të jetë e demonstruar qartë që zbatimi, funksionimi e mirëmbajtja e projektit janë brenda funksioneve të Njesisë së Qeverisjes Vendore dhe se projekti nuk varet nga funksionet e ndonjë institucioni tjetër për tu zbatuar/vënë në funksionim/mirëmbajtur. Në raste pasigurie NJQV-ja duhet ta diskutojë këtë me stafin e dldp-së.

B) Projekti është dorëzuar brenda afateve kohore

Stafi i dldp-së do t'i regjistrojë të gjithë formularët e aplikimit në një regjistër dhe do të regjistrojë datën e hyrjes të secilit projekt.

C) Projekti i propozuar nuk është një investim i pjesshëm

Projektet e propozuara nuk duhet të jenë pjesë e një projekti më të madh që në të ardhmen do të mbështetet nga fonde të tjera që nuk janë siguruar akoma.

D) Konfirmim që NJQV-ja do të paguajë 20 % të kontributit financiar

Në fazën e parë, NJQV-ja në letrën shoqëruese të firmosur e vulosur nga përfaqësuesi i vet më i lartë duhet të angazhohet se do paguajë me mjete financiare (do të thotë që kontributet në natyrë, puna, materialet etj. nuk janë të pranueshme si kontribut) nga buxheti i vet të paktën 20 % të kostos totale të projektit.

E) Ka një Vendim të Këshillit të Komunës që e mbështet projektin si prioritet

Në formularin e aplikimit, NJQV-ja duhet të bashkëngjisë një vendim nga këshilli i NJQV-së që e mbështet aplikimin dhe pohon se është një prioritet për Këshillin.

F) Konfirmim i çështjeve të pronësisë

Në rast se projekti është një investim i vogël, apo përmirësim i shërbimeve që do të ndodhin në një territor të caktuar, NJQV-ja duhet të sjellë një letër së bashku me aplikimin ku pohon se vendndodhja e projektit është pronësi publike dhe se nuk ka konflikte të hapura ppronësie në atë tokë/ndërtesë. Projekti nuk do të paguajë për kompensimin e aseteve. Në rast se ka dyshime pas këtij konfirmimi, stafi i dldp-së, (vlerësuesit) kanë të drejtë të kërkojnë sqarime të mëtejshme dhe dokumente shtesë (p.sh certifikatë pronësie nga ZRPP, vendime të gjykatave etj.)

KRITERET E VLERËSIMIT:

Kriteret e vlerësimit do të përfshijnë këto grup kriteresh:

- A) Kriteret institucionale dhe të qeverisjes së mirë (aftësitë e NJQV-së + cilësitë e projekt-propozimit)
- B) Krite social-ekonomike (të tilla si ndikimi i pritshëm në ekonominë lokale, varfëria, aspekti gjinor etj.)
- C) Bashkëpunimi ndër-komunal

A. Kriteret institucionale dhe të qeverisjes së mirë. (40 pikë)

1. Harmonizimi me strategjinë lokale apo rajonale (0 deri në 10 pikë)

Plan i Zhvillimit Lokal	NJQV-ja nuk ka një plan të zhvillimit lokal	Projekti është pjesë e planit të Zhvillimit Lokal	Projekti është pjesë e Planit të Zhvillimit Rajonal
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	5	10

Vlerësuesi duhet të kontrollojë në formularin e aplikimit apo në dokumentet bashkangjitur nëse projekti është pjesë e prioriteteve afat-shkurtra në nivel lokal apo rajonal. Të shikohet plani lokal/rajonal bashkangjitur apo i cituar.

2. Cilësia e/kohezioni i përmbajtjes së propozimit përfshirë formën e prezantimit (0 deri në 15 pikë)

Cilësia e përmbajtjes (0 deri në 10 pikë)

Cilësia e përmbajtjes së projekt-propozimit	Dobët	Mesatar	I mirë	Shumë i mirë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5	10

Vlerësuesi do të vlerësojë të mëposhtmet:

- A është përshkruar qartë nevoja e projektit?
- A ka një lidhje të qartë mes problemit të përshkruar dhe objektivave të projektit?
- A janë objektivat/rezultatet e pritshëm realistë?
- A ka një lidhje të qartë mes objektivave të projektit dhe aktiviteteve të propozuar për të arritur atë objektiv?
- A ka një radhitje të qartë të aktiviteteve dhe një kuadër kohor realist për zbatimin?

Cilësia e prezantimit (0 deri në 5 pikë)

Cilësia e prezantimit të projekt propozimit	Dobët	Mesatar	I mirë	Shumë i mirë
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	1	3	5

Vlerësuesi do të vlerësojë bazuar mbi këto pyetje:

- A është projekti i shkruar në gjuhë të kuptueshme me fjali të qarta?
- A është projekti i formatuar me të njëjtin font, karakter, paragraf në të gjithë tekstin?
- A ka materiale të tjera bashkangjitur përveç atyre të detyrueshme (si foto, harta, ilustruese etj).?

3. Kontributi në efektivitetin e qeverisjes (0 deri në 10 pikë)

A do të ketë ndikim zbatimi i projektit në një qeverisje më efektive ?	Jo	Ndikim të vogël	Ndikim të moderuar	Ndikim të madh	Ndikim shumë të madh
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	2	4	7	10

Vlerësuesi do të vlerësojë bazuar mbi këto pyetje:

- A do të përdoret projekti si një mjet për kontrollin më të mirë të territorit?
- A do të gjenerojë projekti të ardhura për Bashkinë/Komunë?
- A do të kontribuojë projekti në përmirësimin e mbledhjes së taksave dhe tarifave?

4. Kontributi në transparencën e qeverisjes vendore (0 deri në 5 pikë)

A do të ndikojë zbatimi i projektit në një qeverisje vendore më transparente?	Jo	Ka mundësi si një efekt jo të drejtpërdrejtë	Është një nga objektivat e projektit
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	3	5

- Vlerësuesi do të vlerësojë bazuar mbi këto pyetje:
- A është projekti i orientuar drejt informimit të qytetarëve në proceset vendim-marrëse në nivel lokal?
- A është projekti i orientuar drejt forcimit të pjesëmarrjes qytetare¹?

¹ Këtu bëhet fjalë për përmbytjen e projektit (pra nëse projekti është një qendër informimi, dyqan me një ndalesë etj.) Cilësia e pjesëmarrjes së publikut gjatë zbatimit do të vlerësohet në fazën e dytë.

B. Kriteria social-ekonomike:

1. Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë (0 deri në 10 pikë)

Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë (banorë për më tepër se 6 muaj në lagjen/fshatin e projektit)	< 500	500-1,000	1,000-1500	1,500-3,000	>3,000
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	2	4	7	10

Vlerësuesit do të vlerësojnë bazuar në të dhënat në formularin e aplikimit. Nëse është e nevojshme, ata do të ri-verifikojnë numrin e përfituesve bazuar në të dhëna të tjera për numrin e popullsisë dhe veçanërisht do të shikojnë përcaktimin e përfituesve të drejtpërdrejtë të projektit. Në rast se popullsia përfituese është më tepër se 3,000, apo numri i përfituesve jo të drejtpërdrejtë është shumë i lartë, atëherë projekti mund të marrë pikët maksimale (10 pikë).

2. Ndikimi i pritshëm në sektorët e ekonomisë (ndikim të veçantë në turizëm, bujqësi, mbështetje ndaj biznesit) (0 deri në 5 pikë)

Ndikimi ekonomik	Ndikim i ulët	Ndikim i moderuar	Ndikim i madh
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	2	5

Vlerësuesit bazuar në përvojën e tyre dhe njohuritë rreth rajonit do të vlerësojnë nëse projekti do të ketë një ndikim të mundshëm në sektorët e ekonomisë apo është thjesht një përmirësim shërbimesh.

3. Shkalla e varfërisë e NJQV-së² (0 to 5 pikë)

% e banorëve nën nivelin e varfërisë në NJQV-në propozuese	<10%	10-20%	20-30%	>30%
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	2	3	5

² Lista me % e varfërisë së NJQV-ve, e matur si % e banorëve nën nivelin e varfërisë është bashkangjitur

Varfëria është e dhënë bazuar në matjen më të fundit të nivelit të jetesës në nivel NJQV-je në vitin 2008 (INSTAT/Banka Botërore/UNDP). Të dhënat do tu jepen vlerësuesve nga stafi i dldp-së.

4. Orientimi drejt grupeve në nevojë (0 deri në 5 pikë)

A janë përfituesit e projektit një grup në nevojë (të rinj/fëmijë/të moshuar/minoritete)	Jo	Si efekt jo i drejtpërdrejtë	Po
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	2	5

Projekti do të marrë pikët maksimale nëse në objektivin e projektit është shprehur qartë përmirësimi i jetesës për grupet e përmendura dhe do të marrë pikët mesatare (2) nëse është argumentuar se zbatimi i projektit do të ketë efekt tek grupet e përmendura, pavarësisht se jo si objektivi primar.

5. Orientimi drejt grave (0 deri në 10 pikë)

A janë gratë përfitueset e synuara të projektit?	Jo	Si efekt jo i drejtpërdrejtë	Po
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	5	10

Projekti do të marrë pikët maksimale nëse në objektivin e projektit është shprehur qartë përmirësimi i jetesës për gratë dhe do të marrë pikët mesatare (5) nëse është argumentuar se zbatimi i projektit do të ketë efekt tek gratë, pavarësisht se jo si objektivi primar.

6. Nevoja e menjëhershme për projektin (0 deri në 5 pikë)

A ka një nevojë urgjente të fortë për projektin?	Jo	Po
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	5

Këto pikë mund t'i marrin shumë pak projekte. Gjendet si kriter për të mbështetur projekte që kanë një ndikim të thellë në jetët e njerëzve, si p.sh krijimi i aksesit në shërbimet e shëndetësisë dhe edukimit, lëvizshmërisë etj. (p.sh një urë lidhëse në një fshat të izoluar, riparimi i një klase kur nxënësit janë të detyruar të mësojnë në fshatra të tjerë etj.)

C. Bashkëpunimi ndër-komunal

1. Bashkëpunim mes NJQV-ve për sjelljen e projekteve të përbashkëta

A është propozuar projekti nga më tepër se një NJQV?	Jo	2 NJQV	>2 NJQV
Pikëzimi (numri i pikëve)	0	15	20

Formulari i aplikimit duhet ta tregojë qartë numrin e NJQV-ve që aplikojnë.

Shtojca 5 2: Shpjegimi i kritereve për vlerësuesit për fazën e projekt propozimeve të plota

A. Kapacitetet financiare dhe menaxhuese të aplikantit: (20 pikë)

1. Vlera e bashkëfinancimit (0 deri në 10 pikë)

Vlera e bashkëfinancimit	20 %	20- 30 %	30-40 %	40-50%	>50%
Pikëzimi (pikë)	0	4	6	8	10

Bazuar në informacionin e kërkuar nga formulari i aplikimit në seksionin e buxhetit, vlerësuesit duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë shumën e angazhuar për bashkëfinancim nga NJQV-ja.

2. Përvoja në menaxhimin e projekteve të ngjashme (0 deri në 10 pikë)

Numri i projekteve të një natyre të ngjashme financiar nga vetë NJQV-ja, donatorët apo qeveria qendrore në tre vitet e kaluara (08; 09;10)	0	1	2	4	>4
Pikëzimi (pikë)	0	2	4	7	10

Të dhënat do të jenë në formularin e aplikimit ku NJQV-së i është kërkuar të plotësojë një listë me projekte të natyrave të ngjashme (të ngjashme përsa i përket përmbajtjes së projektit). Vlerësuesit duhet të vlerësojnë kryesisht nëse të gjithë projektet e paraqitura në listë nga NJQV-ja mund të klasifikohen realisht si të një natyre të ngjashme.

B. Cilësitë teknike të projekt-propozimeve të plota (40 pikë)

1. Cilësia e përmbajtjes së projekt-propozimit (0 deri në 10 pikë)

Në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e bërë në fazën e parë, vlerësuesit do të gjykojnë rreth cilësisë së projektit të propozuar. Normalisht, duke qenë se jemi në fazën e projekt propozimeve të plota kërkesat për cilësi janë më të larta.

Cilësia e përmbajtjes

Cilësia e përmbajtjes së projekt-propozimit	E dobët	Mesatare	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë)	0	3	5	10

Vlerësuesi do të gjykojë bazuar mbi të mëposhtmet:

- A ka një përshkrim të qartë dhe shterues të sfondit, strategjive që lidhen me projektin dhe një analizë të mirë të problemit?
- A ka një lidhje të qartë mes problemit të përshkruar dhe objektivave të projektit?
- A janë objektivat/rezultatet e pritshëm realistë?
- A ka një lidhje të qartë mes objektivave të projektit dhe aktiviteteve të propozuar për të arritur atë objektiv?
- A përputhen aktivitetet e propozuara nga projekti me analizën e problemit? A ka një kuadër kohor realist? A janë të përshkruara qartë përgjegjësitë për zbatimin e projektit?

2. Cilësia e prezantimit e projekt-propozimit të plotë (0 deri në 5 pikë)

Cilësia e prezantimit e projekt-propozimit	E dobët	Mesatare	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë)	0	1	3	5

Vlerësuesi do të gjykojë bazuar mbi të mëposhtmet:

- A është projekti i shkruar në gjuhë të kuptueshme me fjali të qarta?
- A është projekti i formatuar me të njëjtin font, karakter, paragraf në të gjithë tekstin?
- A ka materiale të tjera bashkangjitur përveç atyre të detyrueshme (si foto, harta, ilustruese etj).?

3. Cilësitë e dokumentacionit mbështetës (0 deri në 15 pikë)

Cilësitë e dokumentacionit mbështetës	E dobët	Mesatare ³	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë)	0	5	10	15

Vlerësuesi do të gjykojë bazuar mbi të mëposhtmet:

- Cilësia e projektit teknik në rast investimesh apo shërbimesh publike. Në rastin e investimeve, cilësia do të matet bazuar në standarde të pranuar inxhinierike.

³ Në rast se projekt propozimi i plotë do të ketë 5 pikë ose më pak në këtë kriter apo 20 pikë ose më pak në të gjithë seksionin B të vlerësimit projekti do të s'kualifikohet.

- Cilësia e termave të referencës apo draft kontratave në rastin e projekteve studimore. Në përgjithësi, vlerësuesit do të vlerësojnë nëse të gjithë dokumentet e nevojshëm janë gati për prokurimin e shërbimeve/punimeve.
- Gatishmëria e dokumentacionit mbështetës për zbatim (A janë gati lejet e nevojshme për zbatimin e projektit?)

4. Buxheti edhe efektiviteti i kostos (0 deri në 10 pikë)

Cilësia e buxhetit të propozuar	E dobët	Mesatare ⁴	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë)	0	3	5	10

Vlerësuesi do të gjykojë bazuar mbi të mëposhtmet:

- A janë kosto e projektit të bazuar në llogaritje dhe paravlerësime realiste?
- A ka një argument të fortë të kostove të projektit në buxhetin e paraqitur bazuar në përvoja të mëparshme apo manuale çmimesh zyrtare?
- A janë shpenzimet e propozuara të nevojshme për zbatimin e projekteve?

C. Qëndrueshmëria e projektit (20 pikë)

1. A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme institucionalisht? (0 deri në 10 pikë)

Qëndrueshmëria institucionale e projektit	E dobët	Mesatare	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë)	0	3	5	10

Vlerësuesit do të gjykojnë bazuar në informacionin e dhënë në formularin e aplikimit dhe në cilësinë e planit të funksionimit e mirëmbajtjes:

Nëse projekti i propozuar është investim:

- Përvoja në mirëmbajtjen/funksionimin e projekteve të ngjashëm?
- A ka NJQV-ja struktura të afta për mirëmbajtjen/funksionimin e projektit?
- A i përshkruan plani i mirëmbajtjes rregullimet e nevojshme institucionale për mirëmbajtjen/funksionimin e projektit?

⁴ Në rast se projekt propozimi i plotë do të ketë 3 pikë ose më pak në këtë kriter apo 20 pikë ose më pak në të gjithë seksionin B të vlerësimit projekti do të skualifikohet.

Nëse projekti është një fushatë informimi/komunikimi apo projekt tjetër jo investim:

- A është koncepti i qëndrueshmërisë i përshkruar qartë në projekt propozimin e plotë?
- A parashikon projekti ngritje kapacitetesh të aktorëve lokalë që ata të marrin përsipër funksionin e krijuar pas përfundimit të projektit?

Nëse projekti i propozuar është studim:

- A ka një plan veprimi të qartë për zbatimin e gjetjeve të studimit?
- A i parashikon projekti hapat e nevojshëm për formalizmin e këtyre planeve? (si aprovimi në Këshillat e NJQV-ve?)

2. A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme financiarisht? **(0 deri në 10 pikë)**

Qëndrueshmëria financiare e projektit	E dobët	Mesatare	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë)	0	3	5	10

Vlerësuesit do të gjykojnë bazuar në informacionin e dhënë në formularin e aplikimit dhe në cilësinë e planit të funksionimit e mirëmbajtjes:

Nëse projekti i propozuar është investim:

- A janë kostot e funksionim/mirëmbajtjes të bazuara në paravlerësime dhe llogaritje realiste?
- A mund t'i mbulojë buxheti i NJQV-së kostot e funksionimit/mirëmbajtjes?
- A do të mundet vetë projekti të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e funksionimit/mirëmbajtjes ?

Nëse projekti është një fushatë informimi/komunikimi apo projekt tjetër jo investim:

- A është kostoja e qëndrueshmërisë së veprimeve të projektit e mbulueshme nga buxheti i NJQV-së?
- A do të mundet vetë projekti të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e veprimeve të parashikuara në seksionin e qëndrueshmërisë?

D. Aspekte të vlerës së shtuar që sjell projekt-propozimi i plotë (20pikë)

1. Përfshirja e aspektit gjinor në projekt (0 deri në 10 pikë)

Cilësia e përfshirjes së aspektit gjinor në projekt propozimin e plotë	E dobët ⁵	Mesatare	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë)	0	3	5	10

Vlerësuesi do të gjykojë bazuar mbi të mëposhtmet:

- A është projekt propozimi i plotë i orientuar drejt nevojave të grave?
- A janë gratë një përqindje e konsiderueshme e përfituesve?
- A do të kontribuojë projekti në ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit për çështjet gjinore në komunitetin vendor apo qeverisjen vendore përfituese?
- Pjesëmarrja e parashikuar e grave gjatë zbatimit të projektit.

2. Inovacioni (0 ose 5 pikë)

A është projekt propozimi i plotë novator në idenë, metodologjinë e zbatimit apo teknologjitë e propozuara për tu përdorur?	Jo	Po
Pikëzimi (pikë)	0	5

Ideja e kriterit është promovimi i inovacionit në këto linja:

- A është ideja e përshkruar origjinale apo unike në raport me propozimet e tjera apo në përgjithësi në llojin e shërbimeve që zakonisht ofrohen nga NJQV-të?
- A përfshin metodologjia e zgjedhur për zbatimin e projekti veprime, struktura dhe mënyra zbatimi novatore?
A parashikon projekti përdorimin e teknologjive novatore që kanë një mundësi zgjerimi të përdorimit të tyre në të ardhmen?

Mekanizmi i pikëzimit është i tillë që t'i japë 5 pikë **maksimumi tre propozimeve**, (nëse do e meritojnë), që me të vërtetë sjellin diçka të re në raport me pikat e përshkruara më sipër.

⁵ Në rast se projekti do të marrë 0 pikë në këtë kriter do të skualifikohet

3. Transparenca gjatë zbatimit (0 deri në 5 pikë)

Cilësia e planit të transparencës për komunitetin përfitues gjatë zbatimit të projektit?	E dobët	Mesatare	E mirë	Shumë e mirë
Pikëzimi (pikë))	0	1	3	5

Vlerësuesi do të gjykojë bazuar mbi të mëposhtmet:

- A ka një plan të informimit të qytetarëve gjatë zbatimit të projektit?
- Shpeshësia dhe metodat e informimit gjatë zbatimit të projektit?
- A është parashikuar një pjesëmarrje aktive e qytetarëve gjatë zbatimit të projektit? (Projekti mund të marrë pikët maksimale në këtë kriter vetëm nëse është parashikuar pjesëmarrje aktive).

Shtojca 5 3: Formati i raportimit për vlerësuesit për fazën e projekt-koncepteve

Raport vlerësimi faqe 1/4:

NJQV: _____

Titulli i projektit: _____

A. Kriteret institucionale dhe të qeverisjes së mirë (40%)	Pikëzimi
1. Harmonizimi me strategjinë lokale apo rajonale	/10
2. Cilësia/kohezioni i përmbajtjes së propozimit përfshirë formën e prezantimit	/15
3. Kontributi në efektivitetin e qeverisjes	/10
4. Kontributi në transparencën e qeverisjes vendore	/5
Pikëzimi total	/40
Komente ¹ : (veçanërisht në kriteret 2,3 dhe 4):	

¹ Komente duhet të bëhen veçanërisht në kriteret që kanë një vlerësim më subjektiv. Sidoqoftë, në rast dyshimesh, duhet të bëhen komente për të gjitha pikat.

B. Kriteria social-ekonomike (40%)	Pikëzimi
1. Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë	/10
2. Ndikimi i pritshëm në sektorët e ekonomisë	/5
3. Shkalla e varfërisë e NJQV-së	/5
4. Orientimi drejt grupeve në nevojë	/5
5. Orientimi drejt grave	/10
6. Nevoja e menjëhershme për projektin	/5
Pikëzimi total	/40
<p>Komente: (veçanërisht për pikat 1,2 ,4,5 dhe 6):</p>	

C. Bashkëpunimi ndërkomunal (40%)	Pikëzimi
1. Bashkëpunimi ndërkomunal	/20
Pikëzimi total	/20
Komente:	

Pikëzimi final	Pikëzimi
Kriteret institucionale dhe të qeverisjes së mirë	/40
Kritere social-ekonomike	/40
Bashkëpunimi ndërkomunal	/20
Totali	/100
Komente të tjera të përgjithshme :	
_____	_____
Emri dhe firma e vlerësuesit	Emri dhe firma e vlerësuesit
_____	_____
Emri dhe firma e vlerësuesit	Emri dhe firma e vlerësuesit
_____	_____
Emri dhe firma e vlerësuesit	Emri dhe firma e vlerësuesit

Shtojca 5 4: Formati i raportimit për vlerësuesit për fazën e projekt-propozimeve të plota

Raport vlerësimi faqe 1/5:

NJQV: _____

Titulli i projektit: _____

A. Kapacitetet financiare dhe menaxhuese të aplikantit: (20 %)	Pikëzimi
1. Vlera e bashkëfinancimit	/10
2. Përvoja në menaxhimin e projekteve të ngjashme	/10
Pikëzimi total	/20
Komente ¹ :	

¹ Komente duhet të bëhen veçanërisht në kriteret që kanë një vlerësim më subjektiv. Sidoqoftë, në rast dyshimesh, duhet të bëhen komente për të gjitha pikat.

Raport vlerësimi faqe 2/5:

B. Cilësitë teknike të projekt-propozimeve të plota (40 %)	Pikëzimi
1. Cilësia e përmbajtjes së projekt-propozimit	/10
2. Cilësia e prezantimit e projekt-propozimit të plotë	/5
3. Cilësitë e dokumentacionit mbështetës ²	/15
4. Buxheti edhe efektiviteti i kostos ³	/10
Pikëzimi total	/40
Komente:	

² Në rast se projekt propozimi i plotë do të ketë 5 pikë ose më pak apo më 20 pikë apo më pak në seksionin B, projekti do të skualifikohet. Në këtë rast nevojiten komente të qarta dhe të detajuara.

³ Në rast se projekt propozimi i plotë do të ketë 3 pikë ose më pak apo më 20 pikë apo më pak në seksionin B, projekti do të skualifikohet. Në këtë rast nevojiten komente të qarta dhe të detajuara.

C. Qëndrueshmëria e projektit (20 %)	Pikëzimi
1. A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme institucionalisht?	/10
2. A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme financiarisht?	/10
Pikëzimi total	/20
Komente:	

D. Aspekte të vlerës së shtuar që sjell projekt-propozimi i plotë (20 %)	Pikëzimi
Përfshirja e aspektit gjinor në projekt	/10
Inovacioni	/5
Transparenca gjatë zbatimit	/5
Pikëzimi total	/20
Komente:	

Pikëzimi final	Pikëzimi
Kapacitetet financiare dhe menaxhuese të aplikantit	/20
Cilësitë teknike të projekt-propozimeve të plota	/40
Qëndrueshmëria e projektit	/20
Aspekte të vlerës së shtuar që sjell projekt-propozimi i plotë	/20
Totali	/100
Komente të tjera të përgjithshme :	
<hr/> Emri dhe firma e vlerësuesit	
<hr/> Emri dhe firma e vlerësuesit	
<hr/> Emri dhe firma e vlerësuesit	



Shtojca 6 Marrëveshja e bashkëfinancimit me bashkinë/komunën

Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim në Qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës (PZHLD)

Marrëveshje e Bashkëfinancimit të Projekteve me

Bashkia/Komuna _____

Projekti	“Plotëso emrin e projektit” e referuar këtu e në vijim si Projekti .
Mes	Intercooperation (IC) Shqipëri, zyra e programit të PZHLD në Shkodër Përfaqësuar nga plotëso emrin, titullin , Menaxher Programi e referuar këtu e në vijim si IC Shqipëri
Dhe	Bashkia/Komuna _____ Përfaqësuar nga plotëso emrin , Kryetar i Bashkise e referuar këtu e në vijim si Bashkia/Komuna
Kontributi i IC përmes Programit për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (IC Shqipëri)	Maksimumi 40 000 Euro (dyzet mijë EURO) (paguar ne lek me kursin ditor të xx Bank ditën që bëhet pagesa).
Kontributi i Bashkise	Fut shumën (Fut shumën me fjalë) lekë
Periudha e Marrëveshjes	Plotëso numrin e muaj
Data e Firmosjes	Plotëso datën

HYRJE

Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim	<i>1.1 Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim në Qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës, financuar nga Qeveria Zvicerane (SDC) mbështet Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) në Qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës dhe zbatohet nga IC Shqipëri.</i>
Kuadri ligjor	<i>1.2 Baza ligjore e kësaj marrëveshjeje shërben Marrëveshja kuadër ndërqeveritare mes Konfederatës së Zvicrës dhe Qeverisë së Shqipërisë për bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar, nënshkruar me plotëso datën dhe ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin Nr. plotëso numrin dt. plotëso datën si dhe Marrëveshja e Programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal në rajonin e Shkodrës dhe Lezhës nënshkruar mes qeverive të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane me plotëso datën.</i>
Programi i IC Shqipëri	<i>1.3 Qëllimi kryesor i PZHLD është: kapacitetet e bashkive dhe komunave në Shkodër e Lezhë janë forcuar duke kontribuar në forcimin e zhvillimit rajonal në Veri të Shqipërisë dhe në reformën e decentralizimit në nivel kombëtar.</i>
Përmbajtja e marrëveshjes	<i>1.4 Kjo marrëveshje mbulon mbështetjen për zbatimin e projektit “plotëso emrin e projektit”, pjesë e mbështetjes së IC Shqipëri/PZHLD për Bashkinë/Komunën plotëso emrin në kuadrin e PZHLD-së. Detajet e projektit jepen në Aneksin I.</i>

Projektet e NJQV-ve dhe procedura perzgjedhese

Legjitimiteti i projektit	<i>1.5 IC Shqipëri ka përcaktuar një listë kriteresh të detyrueshme për kualifikimin e projekt propozimeve, si dhe një listë kriteresh shtesë me “pikëzim” për vlerësimin e projekteve. Projektet janë perzgjedhur përmes një procesi konkurrues bazuar në kritere që matin cilësinë e projektit, rëndësinë ndaj qëllimeve të programit dhe ndikimin e pritshëm tek NJQV-të dhe komunitetet lokale përfituese.</i>
Procedurat e perzgjedhjes	<i>1.6 Të gjitha projektet e perzgjedhura për bashkëfinancim u vlerësuan në dy faza nga ekspertë të Qarqeve dhe ekspertë të jashtëm bazuar në kriteret e sipërpërmendur. Vendimi përfundimtar u mor nga donatori, SCO-AL, në konsultim me bordin drejtues të fondit grant.</i>
Përgjegjësitë për zbatimin e projektit	
Përgjegjësitë për projektin	<i>1.7 Bashkia/komuna ka përgjegjësinë e plotë për projektin teknik dhe specifikimet që lidhen me të; prokurimin; sigurimin e të gjitha lejeve dhe kushteve sipas ligjeve shqiptare në fuqi; menaxhimin, zbatimin dhe supervizimin e projektit; përfshirjen e komunitetit dhe angazhimin e stafit lokal të përfshirë në projekt sipas projekt propozimit, formatit të raportimit dhe planit të përfshirjes së qytetarëve që janë edhe pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje Projekti.</i>
Bashkia /Komuna	<i>1.8 Bashkia/Komuna është e detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e parapara në projekt propozim, në lidhje me pjesëmarrjen e komunitetit, sipas grafikut bashkangjitur kësaj marrëveshjeje.</i>

1.9 Bashkia është gjithashtu përgjegjëse;

1. Të sigurojë të gjitha procedurat ligjore dhe standartet për miratimin e projektit (miratimi nga KRRT-ja e Bashkisë...)
2. Angazhimin financiar: Bashkia/komuna është angazhuar të rezervojë një fond dhe të kontribuojë me së paku **plotëso shumën** bashkëfinancim për zbatimin e projektit. Bashkia/Komuna ka përgjegjësinë kryesore përsa i përket prokurimit dhe sigurimit të të gjitha kushteve dhe **lejeve që kërkohen** nga legjislacioni shqiptar.
3. Bashkia/Komuna është krejtësisht përgjegjëse për zbatimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projektit. Për të siguruar një koordinim dhe bashkëpunim të mirë gjatë gjithë procesit, mes anëtarëve të grupit të punës, me një mandat/autorizim të qartë nga Kryetari i Bashkisë/Komunës, Bashkia/Komuna do të caktojë dhe autorizojë një person si drejtues projekti, i cili do të jetë personi kryesor i kontaktit gjatë projektit.
4. Bashkia/Komuna do të informojë qytetarët në një mënyrë transparente mbi të gjitha detajet e ndërhyrjeve për projektin.
5. Bashkia/Komuna do të garantojë mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e projektit pas përfundimit të tij me një zë të veçantë të buxhetit për mirëmbajtjen në buxhetin e vitit të ardhshëm.
6. Bashkia/Komuna do të raportojë periodikisht për ecurinë e projektit, bazuar në modelet e raportimit të cilat janë të kësaj marrëveshjeje.
7. Detyra si supervizimi, kolaudimi dhe marrja në dorëzim janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e NJQV-së dhe IC Shqipëri vetëm merr pjesë. Prandaj të gjitha pjesët financiare të projektit që lidhen me supervizimin, kolaudimin dhe marrjen në dorëzim duhet të mbulohen nga burime të tjera financiare jashtë kësaj marrëveshjeje nga NJQV-ja.

1.10 IC Shqipëri është përgjegjëse;

1. Të marrë pjesë në komisionin e tenderit (vlerësimit të ofertave) të monitorojë procesin e zbatimit të projektit dhe marrjes në dorëzim të punimeve.
2. IC Shqipëri, do të japë edhe disa rekomandime për bashkinë për disa para-kushte që do të plotësohen nga kompania zbatuese e përzgjedhur apo disa detaje për materialet që do të përdoren.
3. Të emërojë një person si përgjegjës i projektit për IC Shqipëri, që do të jetë personi kryesor i kontaktit. IC gjithashtu do të monitorojë rregullisht dhe do të konsultojë progresin e punës së bërë nëpërmjet një inxhinieri.
4. Angazhimi financiar: IC Shqipëri angazhohet të rezervojë në buxhetin e saj të programit PZhLD një shumë maksimumi prej 40 000 EURO¹ për zbatimin e punimeve pas përfundimit dhe miratimit të projektit teknik.

IC Shqipëri

Pronësia

1.11 Të gjitha punët e ekzekutuara brenda Projektit janë pronë e Bashkisë/Komunes.

¹ Me kursin ditor të XX Bank

Marrëdhënia me kontraktorin.

1.12 Për zbatimin e projektit teknik, bazuar në këtë marrëveshje, Bashkia do të nënshkruajë një kontratë të veçantë me kontraktuesin, përcaktuar si fitues në fund të një procesi të rregullt tenderues në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.13 Përpara se të nënshkruhet kontrata mes Bashkisë/Komunës dhe kontraktorit për zbatimin e punimeve, Bashkia/Komuna duhet të konsultohet me IC Shqipëri. Bashkia/Komuna do të përfshijë në marrëveshjen e saj përfundimtare me kompaninë fituese edhe disa rekomandime të mundshme të IC.

Buxheti i Projektit dhe Bashkë-financimi

Përcaktimi i vlerës totale të buxhetit

1.14 Vlera e përgjithshme totale e buxhetit **për prokurimin e punës që parasheh ky projekt** është përcaktuar në një vlerë të përafërt prej **plotëso shumen** **█** leke (**shih detajet më poshte**).

Palët bashkë-financuese

1.15 Palët bien dakort të kontribuojnë me vlerat e mëposhtme për bashkëfinancimin e projektit:

- Kontributi i IC Shqipëri përmes PZHLD:= **plotëso shumën** EURO paguar në Leke shqiptare sipas kursit ditor të **XX** Bank në momentin e kryerjes së transfertës për në llogarinë e Bashkisë/Komunes **XX** në degën e Thesarit).
- Kontributi i Bashkisë:= **Plotëso shumën** Lek

Bashkë-financimi i IC Shqipëri nuk mund të shtohet, edhe nëse kostot përfundimtare të projektit janë më të larta.

Parime bazë për bashkë-financimin e IC Shqipëri

1.16 IC Shqipëri nuk bashkëfinancon punë të kryer nga punonjësit e NJQV-së apo staf i tyre me kohë të pjesshme apo ndonjë kosto tjetër operative të bashkisë/komunës.

Financimi i projektit dhe procedurat e pagesave

Marrëveshje mbi pagesat

1.17 Në mënyrë që të mundësohen pagesa transparente, i gjithë fondi për rimbursimin e punimeve do të derdhet në llogarinë e Thesarit në Bankën **XX** për Bashkinë/komunën.

Nr.llogarisë: _____, Dega Thesarit, Plotëso **emrin e bashkisë/komunës**.

² Kjo shume është llogaritur duke konsideruar kursin e dt. **plotëso datën** të xx Bank 1 Euro= **±plotëso vlerën** Lek. **Shuma e saktë do të llogaritet me kursin ditor të pagesës.**

E drejta për të ndërprerë bashkë-financimin nga IC SHQIPËRI	1.18 IC Shqipëri rezervon të drejtën për të mbyllur bashkë-financimin e Projektit në rast se projekti zbatohet në mënyrë të papërshtatshme apo në rast se detyrimet për të cilat është rënë dakort nuk përmbushen, pasi ka informuar fillimisht me shkrim Bashkinë.
	1.19 Kontributi i Bashkisë do të jetë gjithnjë minimumi 20 % i ofertës, nëse oferta fituese është më e ulët se kontributi i IC Shqipëri. Në këtë rast kontributi i IC Shqipëri do të reduktohet sipas ofertës fituese.
Monedha e llogarisë	1.20 Derdhja e fondit dhe pagesat nga ky fond do të kryhen përmes llogarisë së Degës së Thesarit <i>plotëso ermin e degës XX Bank</i> , në lekë shqiptare.
Tejkalimi i kostove	1.21 Në rast të tejkalimit të kostove për të cilat është rënë dakort, konfirmuar këto edhe në buxhetin total, Bashkia do të jetë përgjegjëse për shlyerjen e vlerës shtesë.
Rregullimi i pagesave dhe grafiku i pagesave	1.22 IC Shqipëri do të derdhë fondin e bashkëfinancimit në llogari të Degës së Thesarit <i>plotëso ermin e degës</i> në një këst, (pas aprovimit të raportit). <ul style="list-style-type: none"> • Pagesa e bashkëfinancimit të IC Shqipëri do të bëhet pasi IC Shqipëri të aprovojë raportin përfundimtar të bashkisë sipas formatit që i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje.
Fondet e garancisë	1.23 Bazuar në ligj dhe në kontratën që do të lidhë me kontraktorin, Bashkia do të administrojë fondin prej 10% të garancisë së ofertës fituese dhe më pas fondin prej 5% (në llogarinë e Thesarit) për garancinë e punimeve me të cilin do të garantojë riparimin e të gjitha defekteve gjatë periudhës së garancisë. Minimumi i periudhës së garancisë është 12 muaj. IC Shqipëri do të informohet nga Bashkia sa dhe si është përdorur fondi i garancisë.
Procedura e Thesarit	1.24 IC Shqipëri do të respektojë rregullat dhe procedurat e thesarit për transferimin e fondeve, konform grafikut dhe kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
Pagesa të tjera.	1.25 IC Shqipëri nuk është dhe nuk mund të bëhet përgjegjëse për çdo lloj pagese tjetër nga ato që u listuan më lart

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit	1.26 Prokurimi i këtij projekti do të kryhet nga Bashkia, në përputhje me ligjin për Prokurimet Publike (<i>Ligj. Nr.9643 dt. 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin No. 9800, dt. 10.09.2007, ndryshuar me Ligjin No. 9855, dt. 26.12.2007</i>) dhe strikt sipas kërkesave që parashikon Projekti. <p>IC Shqipëri rezervon të drejtën për të emëruar një anëtar në komisionin e tenderit.</p> <p>Në çdo rast, Bashkia/Komuna do t'i dorëzojë IC Shqipëri për koment të gjithë informacionin, proces verbalin dhe raporte respektive (me dokumentacionin përkatës) për kontraktuesin/furnizuesin e propozuar për t'u shpallur fitues, përpara se të merret vendimi përfundimtar mbi</p>
-------------------------	--

përzgjedhjen e kontraktuesit.

Për çdo rast ankese në lidhje me procedurat e prokurimit, bashkia do të informojë IC Shqipëri në kohë.

Raportimi dhe informimi

Shpërndarja e informacionit	1.27 <i>Bashkia/komuna bie dakord që çdo informacion dhe përvojë e krijuar në lidhje me projektin do të shpërndahet brenda Bashkisë dhe i ofrohet IC Shqipëri dhe/ose njësitëve të tjera partnere të PZHLD.</i>
Mbajtja e raporteve dhe të dhënave	1.28 <i>Të gjitha palët pjesëmarrëse do të mbajnë shënime mbi kontributet e tyre dhe për rrjedhojë një kuadër i përgjithshëm i “burimeve të investuara” për projektin do të raportohet sipas formatit të raportimit të IC Shqipëri.</i>
Kushte paraprake	1.29 <i>Përpara fillimit të punimeve Bashkia/Komuna do t’i dorëzojë IC Shqipëri listën e dokumenteve sipas modeleve të raportimit bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje (leje ndërtimi etj.), si një kusht paraprak që IC Shqipëri të paguajë pjesën e saj të bashkëfinancimit.</i>
Raporti përfundimtar	1.30 <i>Në fund të projektit, përpara pagesës përfundimtare, një raport përfundimtar do të paraqitet tek IC Shqipëri sipas formatit të raportimit. (bashkëlidhur tek anekset).</i> 1.31 <i>Dokumente dhe informacione të tjera mund të kërkohen nga IC Shqipëri gjatë zbatimit të projektit.</i>
Informimi i IC Shqipëri për ngjarje të rëndësishme	1.32 <i>Bashkia/Komuna është e detyruar të para-informojë IC Shqipëri, në kohë të mjaftueshme, për organizimin e ngjarjeve të rëndësishme, që kanë të bëjnë me zbatimin e projektit, në mënyrë që IC Shqipëri të marrë masat të jetë prezent, nëse është e nevojshme. Të tilla ngjarje mund të jenë:</i> <ol style="list-style-type: none">1. Përgatitja e dokumentacionit tenderues dhe shpallja e tenderit2. Ftesa për tender dhe hapja e ofertave3. Përzgjedhja përfundimtare e kontraktuesit dhe lidhja e kontratës4. Takime publike me qytetarë etc.5. Vendime për ndryshime të rëndësishme në projekt dhe zbatimin e tij (psh. ndryshime në zërat e preventivit gjatë zbatimit etj.)6. Planifikimi/organizimi i inaugurimit7. Publikime/marrëdhënie me median mbi projektin

Supervizimi, monitorimi dhe asistenca nga IC Shqipëri

Bashkia/Komuna si përgjegjësi kryesor	<i>1.33 Bashkia/Komuna si përgjegjësjë kryesore për zbatimin e projektit, në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar, do të organizojë koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha aktivitetëve.</i>
E drejta e inspektimit, vlerësimit dhe monitorimit	<i>1.34 IC Shqipëri apo çdo palë e tretë e mandatuar nga IC Shqipëri ka të drejtën të monitorojë dhe inspektojë zbatimin e punimeve dhe ecurinë e projektit, situatën financiare të projektit dhe situacionet, çdo lloj dokumentacioni tjetër në çdo kohë dhe mënyrë që IC Shqipëri e sheh të nevojshme (forma të mundshme janë inspektim personal, auditim/inspektim nga palë të treta). Në këto raste, bashkia/komuna do të mbështesë inspektimin duke ofruar të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe mbështetjen e nevojshme.</i>
Monitorimi nga IC	<i>1.35 IC Shqipëri, do të monitorojë zbatimin e projektit në bashkëpunim me një supervisor të emëruar nga Bashkia/Komuna, dhe me stafin teknik dhe administrativ të bashkisë.</i> <i>1.36 IC Shqipëri do të organizojë mbikqyrjen dhe monitorimin e projektit në këto mënyra;</i> <ul style="list-style-type: none">• <i>Pjesëmarrje si anëtar i komisionit të tenderit.</i>• <i>Mbikqyrje nga ana e IC Shqipëri të zbatimit të punimeve “mbikqyrës i mbikqyrës të bashkisë”; pjesëmarrje në momentet kyç, miratim i situacioneve; miratim i materialeve që do të përdoren, garantim i afateve kohore etj. Inxhinieri i IC do të vizitojë periodikisht sheshin e ndërtimit dhe ai/ajo do të jetë lidhja mes IC Shqipëri dhe komunës për çështje teknike. Të gjitha dokumentet teknike duhet të nënshkruhen prej inxhinierit të IC Shqipëri.</i>• <i>Pjesëmarrje nga ana e IC në kolaudim dhe në marrjen në dorëzim të objektit.</i>• <i>Ana teknike e punimeve do të monitorohet nga inxhinieri i IC. IC do të dorëzojë një listë me dokumentet e kërkuara si pjesë e formateve të raportimit progresiv dhe final. Inxhinieri i IC do të ketë të gjithë ndihmesën e nevojshme prej Bashkisë dhe palëve të treta për të monitoruar dhe vlerësuar procesin e zbatimit.</i>• <i>IC Shqipëri do të monitorojë nga afër informimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit ashtu siç ai është parashikuar në pjesën përshkruese të projekt propozimit. Do të kërkohen prova që vërtetojnë realizimin e planit të pjesëmarrjes qytetare (dhe trajtimin e barazisë gjinore).</i> <i>1.37 IC Shqipëri rezervon të drejtën për të ndërhyrë në rast vështirësish për të përmirësuar zbatimin e projektit.</i> <i>1.38 IC Shqipëri do të mbështesë monitorimin dhe asistencën e projektit nga burime të tjera financiare brenda DLDP.</i>

Auditimi dhe taksat

TVSH, përjashtimi i mundshëm	<i>Buxheti i përgjithshëm është llogaritur duke përfshirë TVSH-në. IC Shqipëri do të advokojë për të përjashtuar vlerën e saj të bashkë-financimit nga TVSH-ja. Në rast të finalizimit me sukses të përpjekjeve, Komuna do të udhëzohet nga IC Shqipëri si do të procedohet për rimbursimin e TVSH-së.</i>
Inspektimi përfundimtar dhe auditimi	<p>1.39 <i>Bashkia bie dakort që t'i ofrojë IC Shqipëri të gjitha raportet e mundshme të kontrolleve dhe inspektimeve të brendshme dhe të jashtme që prekin aktivitetin e bashkëfinancuar nga IC Shqipëri.</i></p> <p>1.40 <i>Bashkia do t'i dorëzojë IC Shqipëri një kopje të kontrollit të përvitshëm financiar të bashkisë (pjesa që përkon me projektin) të kryer nga Prefektura. Nëse IC Shqipëri e sheh të dobishme, mund të ndërmarrë një kontroll të veçantë për aktivitetet e bashkëfinancuar nga IC.</i></p>

Dispozitat e fundit

Periudha e marrëveshjes	1.41 <i>Kjo marrëveshje e projektit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj dhe mbaron kur të gjitha detyrimet e palëve sipas marrëveshjes janë përmbushur (duke përfshirë edhe marrjen në dorëzim të objektit), por jo më vonë se plotëso datën. Të gjitha detyrimet e IC Shqipëri lidhur me këtë projekt do të pushojnë pas kësaj date.</i>
Pjesët përbërëse të kësaj marrëveshjeje	1.42 <i>Projekti teknik, formati i raportimit dhe anekset e tjera, janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.</i> Të gjitha ndryshimet e kësaj marrëveshjeje do të bëhen vetëm me shkrim.
Mospërputhja mes dokumenteve	1.43 <i>Në rast të kundërshtive mes projektit dhe marrëveshjes apo dokumenteve të tjerë, paragrafet udhëheqëse do të jenë ato të marrëveshjes së projektit, duke respektuar objektivat e përgjithshme të IC Shqipëri dhe të programit PZhLD. Rradha e mëposhtme e dokumenteve do të mbizotërojë sipas rëndësisë:</i> <ol style="list-style-type: none">1. Marrëveshja e projektit2. Projekt-propozimi i NJQV-së, që është pjesë përbërëse e marrëveshjes së projektit.3. Protokollet dhe procesverbalet e mbledhjeve
Ndryshimet dhe përfundimi i	1.44 <i>Korrigjimet dhe ndryshimet që konsiderohen të nevojshme dhe dëshirohet që të përfshihen gjatë zbatimit të projektit duhet t'i prezantohen me shkrim IC Shqipëri për diskutim. Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje projekt</i>

marrëveshjes

do të konsiderohen detyruese vetëm nëse ato janë miratuar me shkrim dhe firmosur nga palët.

IC Shqipëri ka të drejtën e ndërprerjes së menjëhershme të kësaj marrëveshjeje për arsye të tilla si vonesa të pajustificuara, menaxhim jokompetent i projektit, cilësi e papëlqyeshme, neglizhencë në zbatimin e projektit, raste mashtrimi dhe korrupsioni, forcë madhore, përkundrejt njoftimit me shkrim drejtuar Bashkise.

Anti-korrupsioni dhe shpërdorimi i fondeve

1.45 Bashkia/komuna dhe/ose të deleguarit e saj nuk do të kryejnë ose tu ofrojnë palëve të treta, ose kërkojnë, pranojnë ose premtojnë direkt ose indirekt për vete ose për një palë tjetër, ndonjë dhuratë ose përfitim i cili do të përbënte ose mund të konsiderohej si një praktikë jo ligjore ose korruptive. Në rast të dyshimeve për shpërdorim fondesh dhe/ose korrupsion, IC Shqipëri mundet menjëherë të anullopë këtë marrëveshje, prokurimin ose shpalljen e fituesit, të bllokojë asetet dhe llogaritë dhe të fillojë procedimin penal ose civil kundër palëve të përfshira siç parashikohet në ligj.

Konflikti i interesave

1.46 Bashkia/Komuna angazhohet që gjatë zbatimit të projektit, ajo do të njoftojë IC Shqipëri me shkrim për çdo rast kur një konflikt interesash mund të vërehet, pavarësisht se ajo është ose jo pjesë e këtij konflikti të mundshëm interesash, pavarësisht nëse ajo do të përfitojë apo jo, ose do të kompensohet, apo jo.

Në rast të një konflikti interesash Bashkia/Komuna i njeh IC Shqipëri të drejtën dhe përgjegjësitë të veprave dhe sigurojë kurdo që të jetë e mundshme që ndonjë konflikt i mundshëm nuk do të zhvillohet dhe ndonjë konflikt i diktuar të mos vazhdojë. IC Shqipëri mund të ndërmarrë çfarëdo veprimi tjetër që konsiderohet i përshtatshëm.

Zgjidhja e konflikteve, Juridiksioni, vendi dhe ligji që do të zbatohet

1.47 Në rast kundërshtish ose konfliktesh që lindin ose lidhen me këtë marrëveshje, palët nëpërmjet saj bien dakord të angazhohen me të gjitha përpjekjet dhe të hyjnë në bisedime në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e pranueshme nëpërmjet negociatave direkte. Ndërhyrjet efektive të Komitetit Drejtues mund të kërkohen për ndërmjetësim. Vetëm nëse nuk gjenden zgjidhje me marrëveshje, çështja mund të dërgohet për zgjidhje para një gjykate shqiptare. Juridiksionin për zgjidhje të kësaj marrëveshjeje e ka Gjykata e rrethit Shkodër, Shqipëri.

Numri i kopjeve të marrëveshjeve, gjuha që ka përparësi.

1.48 Kjo marrëveshje nënshkruhet në Shqipëri dhe Anglisht nga tre kopje për secilën gjuhë, ku secili version është njëllëj autentik. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim mes gjuhës angleze dhe shqipes, versionin anglisht i kësaj marrëveshjeje ka përparësi.

ANEKSET :

1. Projekt propozimi përshkrimor dhe teknik i dorëzuar tek IC Shqiperi nga Bashkia
2. Plani/grafiku i përfshirjes së komunitetit dhe krejt procesi i pjesëmarrjes qytetare dhe monitorimi
3. Projekti teknik i hartuar nga IC Shqipëri dhe aprovuar nga Bashkia
4. Formati i raportimit që përfshin edhe një listë me dokumentet teknike të kërkuara
5. Rekomandime/kritere për dokumentet e tenderit me synim përzgjedhjen e kompanisë zbatuese dhe materialet që do të përdoren

Vendi, data:

Intercooperation Shqipëri

Bashkia/Komuna

Plotëso emrin

Plotëso emrin

IC Shqipëri, **Plotëso funksionin** Menaxher Programi

Kryetar i Bashkisë

Shtojca 7: Letër standarde e konfirmimit të pronësisë

_____, më / /201

Lënda: Konfirmim pronësie

Drejtuar: Programit të Zhvillimit Lokal dhe Decentralizimit

Unë, i nënshkruari Z./Znj. _____, përfaqësues i Komunës/Bashkisë _____ Rrethi _____, Qarku _____, vërtetoj, pas kontrollit në Hipotekë dhe Kadastër, se trualli dhe/ose godina, objekt i kësaj kërkesë për financim, i përket tërësisht pronësisë së Komunës/Bashkisë.

- Deklaroj, me dijen time se nuk ka konflikt pronësie dhe nuk janë ndërmarrë veprime për sa i përket objektit në fjalë.

- I deklaroj, Programit të Zhvillimit Lokal dhe Decentralizimit në emër të Komunës/Bashkisë _____, se do të përdor këtë truall dhe/ose këtë/këto godinë/a për qëllimin e deklaruar në kërkesën për investim.

Emër, Mbiemër, Firma dhe Vula e Kryetarit të Komunës/Bashkisë

Shtojca 8: Formulari i raportit përfundimtar

Ky formular do të përdoret nga Njësitë e Qeverisjes Vendore partnere të programit dldp si model për përgatitjen e raportit përfundimtar pas zbatimit të projektit.

Titulli i projektit:	
Njësia e Qeverisjes Vendore:	
Periudha e raportimit:	
Data e dorëzimit të raportit:	
Autori (ët) e raportit:	

I. Përmbledhje Ekzekutive

--

II. Përmbledhje e objektivave të projektit

--

III. Përshkrimi i aktiviteteve të projektit

--

IV. Analiza e Rezultateve të Projektit

--

V. Qëndrueshmëria

--


VI. Menaxhimi i projektit

--

VII. Pjesëmarrja qytetare gjatë zbatimit të projektit

--

VIII. Orientimi gjinor



IX. Bërja publike e projektit



X. Mësimet e nxjerra



XI. SHTOJCAT

Shtojca 8 1: Udhëzime për përgatitjen e formularit të raportit përfundimtar

Ky formular do të përdoret nga Njësitë e Qeverisjes Vendore partnere të programit dldp si model për përgatitjen e raportit përfundimtar pas zbatimit të projektit.

Titulli i projektit:	
Njësia e Qeverisjes Vendore:	<i>Emri i NJQV-së, Qarkut. Në rastet e bashkëpunimit ndërkomunal listoni të gjitha NJQV-të, duke specifikuar aplikantin kryesor.</i>
Periudha e raportimit:	
Data e dorëzimit të raportit:	
Autori (ët) e raportit:	

I. Përmbledhje Ekzekutive

Ky seksion duhet të jetë një përmbledhje e shkurtër e çështjeve kyçe nga raporti, duke vënë në dukje përfundimet dhe rekomandimet kryesore. (maks. 1 faqe)

II. Përmbledhje e objektivave të projektit

Bëni një përmbledhje të objektivave të projektit dhe të rezultateve të arritura. Ky seksion do të përshkruajë kontekstin e nevojshëm për seksionet e tjera të raportit. (maks 1 faqe)

Për të plotësuar këtë seksion ju lutem përgjigjuni:

- Cilat ishin qëllimet dhe objektivat e projektit?
- Cilët ishin faktorët e suksesit të projektit?
- Cilët ishin treguesit e performancës që u përdorën për të vlerësuar suksesin e projektit? Treguesit duhet të lidhen me çështje të tilla si:
 - Relevanca e projektit: Në çfarë mase objektivat e projektit reflektonin nevojat e komunitetit dhe qëllimin e programit;
 - Eficenca e projektit: Në çfarë mase u përdorën burimet financiare dhe njerëzore në përputhje me aktivitetet e projektit;
 - Efektiviteti i projektit: Në ç' masë u arritën qëllimet e projektit?
 - Ndikimi i projektit: Cili është ndikimi i projektit në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për zhvillimin e komunitetit?
 - Qëndrueshmëria e projektit: si do të sigurohet qëndrueshmëria e projektit pas përfundimit të fondeve? Ju lutem përfshini buxhetin dhe burimet njerëzore të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura.
- Deri në çfarë mase ka kontribuar projekti tek objektivat e përgjithshëm të programit (dldp)?
- Cilët ishin aktorët e projektit? Cilët ishin rolet e tyre të pritshme?
- Në çfarë mase janë ngritur kapacitetet e NJQV-së për menaxhimin e projekteve? Në cilët aspekte nevojitet më tepër mbështetje në të ardhmen?

III. Përshkrimi i aktiviteteve të projektit

Ju lutem përshkruani aktivitete që u ndërmorën gjatë zbatimit të projektit. Ju lutem referohuni projekt propozimit dhe krahasoni atë që ishte planifikuar me atë që u zbatua në praktikë. Është e rëndësishme të përshkruhet nëse projekti u zbatua në përputhje me planifikimin. Nëse jo, ju lutem shpjegoni pse dhe çfarë keni bërë për ta përmirësuar situatën. (max. 3 faqe)

Pyetjet e mëposhtme mund t'ju orientojnë:

- Çfarë aktivitete u ndërmorën gjatë zbatimit të projektit?
- A i përmbushën aktorët detyrat e tyre sipas planifikimit? Nëse jo, çfarë aktivitete u ndërmorën për ta përmirësuar situatën?
- Deri në çfarë mase ishte e mundur t'i përmbaheshit planit të veprimit dhe afatit kohor?
- A pati vonesa apo probleme të tjera në lidhje me zbatimin e projektit, cili ishte efekti i tyre në arritjen e objektivave të projektit? Çfarë u bë për të kapërcyer vonesat apo për të zgjidhur problemet?
- Në çfarë shkalle janë ngritur kapacitetet e stafit të projektit për menaxhim projekteve e zhvillim të komunitetit?

IV. Analiza e Rezultateve të Projektit

Kjo është pjesa më e rëndësishme e raportit. Në raportin përfundimtar, duhet vënë theksi tek ajo çka është arritur si rezultat i zbatimit të projektit. (max. 2 faqe)

Për të bërë një vlerësim të rezultateve duhen analizuar çështjet e mëposhtme:

- *A u përballët me vështirësi teknike gjatë zbatimit të projektit? Nëse po, ju lutem përshkruani. Çfarë mjetesh dhe metodash përdorët për t'i tejkaluar këto vështirësi?*
- *Cilat ishin rezultatet kryesore të projektit? Në çfarë mase kontribuoi përfshirja e komunitetit në arritjen e tyre?*
- *Çfarë aspektesh të reja të menaxhimit mësuat nga zbatimit i projektit? Çfarë mund të ishte bërë ndryshe dhe pse? Cilat janë disa nga mendimet tuaja në lidhje me këtë çështje?*
- *Si kontribuuan rezultatet në qëllimin e përgjithshëm të programit (dldp)?*
- *Cila ishte vlera e shtuar e projekteve të financuar nga IC Shqipëri në kuadër të dldp-së?*

V. Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria është një nga çështjet kyçe në çdo projekt. Nënkupton qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit pas financimit nga IC Shqipëri. Në çdo rast, duhet një vazhdimësi për t'i arritur plotësisht të gjithë objektivat e projektit. Qëndrueshmëria është e lidhur si me projektet e infrastrukturës, ashtu edhe me projektet e tjera.

Për përgatitjen e këtij seksioni përgjigjuni ndaj pyetjeve të mëposhtme:

- *A keni planifikuar ndonjë komponent infrastrukturor për të arritur qëndrueshmërinë e projektit? (buxhet shtesë për mirëmbajtjen e investimeve kapitale, zgjerimin e investimit në të ardhmen, periudha e garancisë etj.). Nëse po, ju lutem specifikoni.*
- *Si mund të aplikohet kjo përvojë dhe kjo njohuri e fituar tek NJQV-të e tjera? Si mund të ndahet kjo përvojë me to?*
- *A ka nevojë për asistencë të mëtejshme pas financimit nga IC Shqipëri?*

VI. Menaxhimi i projektit

Në këtë seksion përshkruani rolin dhe bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm në zbatimin e projektit (Stafi i NJQV-së, supervizori, IC Shqipëri, anëtarët e komunitetit, kontraktori etj.). Theksi duhet vënë tek bashkëpunimi ndërmjet aktorëve dhe punës në skuadër gjatë zbatimit të projektit, pikat e forta dhe të dobëta të menaxhimit të projektit, përvoja e re pozitive sjellë në komunitet nga stafi i projektit, etj. (max. 1 faqe)

VII. Pjesëmarrja qytetare gjatë zbatimit të projektit

Në këtë seksion, ju lutem përshkruani pjesëmarrjen e komunitetit gjatë zbatimit të projektit:

A ndërmori NJQV-ja ndonjë iniciativë për përfshirjen e komunitetit vendor në procesin e zbatimit të projektit?

A u informuan qytetarët rreth projektit, si u arrit kjo?

A kishin mundësi qytetarët të komentnin rreth cilësisë së zbatimit të projektit? A vendosët ndonjë mekanizëm komunikimi?

Më në përgjithësi, në ç'masë ishte pjesëmarrja e komunitetit në zbatimin me efektivitet të fazave të ndryshme të projektit?

VIII. Orientimi gjinor

Në këtë seksion, ju lutem përshkruani ndikimin e projektit në jetën e grave.

A ishin gratë të përfshira drejtpërdrejt gjatë zbatimit të projektit?

A kishte gra që punuan për zbatimin e projektit?

A u konsultuan gratë gjatë fazës së identifikimit apo zbatimit të projektit?

IX. Bërja publike e projektit

A pati ndonjë mbulim nga media për projektin?

A ishte ky mbulim pozitiv apo negativ?

Nëse pati, ku u botuan artikujt e gazetave, në median qendrore apo lokale? Ju lutem jepni numrin e artikujve të botuar dhe titujt e gazetave, bashkëngjitini ato tek raporti.

A pati ndonjë kronikë apo program në median elektronike në nivel qendror apo lokal? Ju lutem jepni numrin e programeve dhe emrin e radiove, televizioneve televizive. Bashkëngjisni regjistrimet nëse është e nevojshme.

X. Mësimet e nxjerra

- Çfarë lloj përvoje pozitive fituat nga zbatimi i projektit?*
- Deri në ç'masë përvoja juaj e re do të ndikojë tek projekte të ardhshme?*
- Sa mund të përfitojnë NJQV-të e tjera nga përvoja jua në zbatimin e projektit? Si mund të ndahet kjo përvojë me to?*
- Çfarë do të raportoni si "histori suksesi" në lidhje me zbatimin e projektit?*

XI. SHTOJCAT

Duhet të përfshijë të gjithë dokumentacionin teknik të kërkuar, si dhe raportet financiare që dokumentojnë përdorimin e burimeve financiare.

Shtojca 9: Rregullorja e Funkcionimit të Bordit Drejtues të fondit grant të dldp-së

I. Të përgjithshme

- Bordi Drejtues i fondit grant të programit dldp është një trupë e përbërë nga aktorët e rëndësishëm të programit me funksion këshillimin e donatorit, SCO-AI për procedurën e shpërndarjes së fondit grant të programit dldp.

II. Përbërja

Ky bord do të përbëhet nga shtatë persona si më poshtë:

- Përfaqësuesi i Donatorit, Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran në Shqipëri.
- Kryetari i Qarkut Shkodër (mund ta delegojë tek Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Rajonal).
- Kryetari i Qarkut Lezhë (mund ta delegojë tek Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Rajonal).
- Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë (mund ta delegojë tek punonjës të tjerë të zyrës me përvojë të përshtatshme).
- Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë (mund ta delegojë tek punonjës të tjerë të zyrës me përvojë të përshtatshme).
- Përfaqësuesi i një donatori tjetër që punon në të njëjtën fushë.
- Përfaqësues nga shoqëria civile e qarqeve përfituese .

III. Përgjegjësitë e Bordit Drejtues

- *Këshillon donatorin për vendim-marrjen për përzgjedhjen e projekteve. Jep komente për fazën e parë të përzgjedhjes së koncepteve të projekteve. Jep komente për fazën e dytë të përzgjedhjes përfundimtare të projekteve për tu financuar.*

- *Miratim i raporteve të monitorimit dhe vlerësim i projektit të zbatuar më mirë.* Miratim i raporteve përfundimtare të dërguara nga NJQV-të. Bazuar në këto raporte dhe të dhëna të tjera merr një vendim për projektin më të mirë dhe i jep mundësinë për një projekt tjetër NJQV-së me performancën më të mirë.
- *Rishikimi i udhëzuesit.* Bazuar në përvojën e raundit të parë i propozon donatorit rishikimin e udhëzimeve, procesit dhe përgjegjësive të aktorëve për raundin e dytë të grantit.

IV. Funksionimi i Bordit Drejtues

- Bordi Drejtues mbledhet me nismën e Kryetarit të Bordit Drejtues në funksion të përmbushjes së përgjegjësive të caktuara.
- Një mbledhje e bordit drejtues do të quhet e vlefshme kur marrin pjesë të paktën pesë anëtarë.
- Vendimet e bordit drejtues do të merren me konsensusin e të gjithë anëtarëve. Nëse nuk arrihet konsensusi mes të gjithë anëtarëve, shumica e thjeshtë e anëtarëve prezentë në mbledhje mjafton për të marrë vendimet.

V. Kryetari i bordit drejtues:

- Në fazën pilot, bordi drejtues do të kryesohet nga përfaqësuesi i donatorit SCO-AL, i cili do të ketë të drejtën e vetos për miratimin e shpërndarjes së fondeve tek projektet.
- Do të mbajë lidhje të ngushta me stafin e dldp-së për përgatitjen e materialeve për çdo mbledhje.
- Do të njoftojë datat e takimeve dhe axhendën për anëtarët e tjerë të bordit.
- Në koordinim me stafin e dldp-së do të përgatisë axhendën për çdo mbledhje.

VI. Sekretariati i Bordit Dejtues

- Staf i programit (dldp) do të veprojë si sekretariat i bordit drejtues.
- Sekretariati do të mbajë shënimet e takimit, të cilat u vihen në dispozicion për komente dhe firmosje anëtarëve të bordit në mbledhjen më të afërt.
- Sekretariati i bordit asiston kryetarin e bordit për organizmin e takimeve, përpilimin dhe shpërndarjen e axhendës.
- Sekretariati është për mbajtjen e arkivës së shënimeve të takimeve dhe të vendimeve të marra nga bordi drejtues

VII. Mbledhja e parë

- Mbledhja e parë thirret nga kryetari i bordit.
- Në mbledhjen e parë konfirmohen anëtarët e bordit drejtues.
- Gjatë kësaj mbledhjeje shpjegohen rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të bordit drejtues.
- Në mbledhjen e parë, anëtarët e bordit drejtues firmosin këtë rregullore.
- Kjo rregullore hyn në fuqi me nënshkrimin e të paktën pesë anëtarëve të bordit drejtues dhe shërben si e tillë për fazën e parë të fondit grant të dldp.